

Kurti takohet me  
ambasadorin Kosnett,  
flasin edhe për dialogun



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", FATMIRE MULHAXHA-KOLLÇAKU | FAQE 5

## FI TORJA E VETËVENDOSJE S ISHTE E PRITSHME

Qeveria Kurti do të jetësohet,  
vullneti i qytetarëve s'mund të  
ndryshohet



Nënkrjetarja e Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, ka thënë se më 6 tetor qytetarët janë përcaktuar për ndryshim substancial në Kosovë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka

theksuar se fitorja e Vetëvendosjes ka qenë e pritshme. Mulhaxha-Kollçaku ka bërë me dije se qeveria e udhëhequr nga Kurti do të jetësohet sepse nuk mund të ndryshohet vullneti i qytetarëve. Sipas saj, nuk

është në favor të asnjë subjekti dhe të shtetit që të kemi zgjedhje të reja. Mulhaxha-Kollçaku ka thënë se interesi i Kosovës dhe qytetarëve të saj është që sa më shpejt të formohet qeveria dhe proceset të ecin përpara

## PZAP-i hedh poshtë ankesat e partive, s'ka rinumërim të votave

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP) ka hedhur, si të palejuara, ankesat nga PDK-ja, LDK-ja dhe koalicioni Nisma-AKR-PD për rinumërim të të gjitha fletëvotimeve nga zgjedhjet e 6 tetorit. Zyrtarët e këtyre subjekteve politike kanë pretenduar se gjatë procesit të numërimit të votave janë bërë disa gabime teknike të cilat do të mund të rregulloheshin vetëm me anë të rinumërimit të të gjithave votave



## ShBA-ja dhe BE-ja presin nga qeveria e re rifillimin e dialogut me Serbinë

Zyrtarët e ShBA-së dhe të BE-së presin formimin e shpejtë të Qeverisë së re të Kosovës. Ata kanë bërë me dije se presin që qeveria e re ta vazhdojë dialogun për normalizim të marrëdhënieve me Serbinë dhe të angazhohet për forcimin e demokracisë dhe paqes në vend

### OPINION

#### PESHËRËNDA VLERËMADHE, VOTË E NËNËS

F. 13

Shkruan: ISA FERIZAJ

### AKTUALE

#### AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT: NUK KA PASUR KONFLIKT INTERESI NË PROVIMIN E NOTERISË F. 6

#### KQZ-ja PËRFUNDON NUMËRIMIN E VOTAVE TË RREGULLTA F. 6

#### DNV-ja E VLERËSON TË QETË DHE ME PARREGULLSI TË VOGLA PROCESIN ZGJEDHOR F. 7



### EKONOMI



#### BANKA BOTËRORE: NË KOSOVË KA PËRPARIM EKONOMIK, POR JO MJAFTUESHËM F. 9

#### 200 PERSONA CERTIFIKOHEN SI TRAJNERË BRENDA KOMPANIVE F. 9

### SPORT

#### FITON GJILANI, ÇALON DRITA

F. 20

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Curëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegijbiznesi.com](http://www.kolegijbiznesi.com)  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANK VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## Rama takon Vuçiqin këtë javë

**TIRANË, 8 TETOR** - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, do të udhëtojë këtë javë për në Novi Sad, për të marrë pjesë në një takim me Aleksandër Vuçiqin dhe Zoran Zaevin, ku në tryezë është projekti i një hapësire të përbashkët ekonomike në Ballkanin Perëndimor. Ideja nuk është e re dhe në këtë tryezë ajo që kërkohet është dakordësimi politik në parim për këtë hap.

Projekti për një zonë ekonomike të lirë në Ballkanin Perëndimor qarkullon prej fillimit të viteve '90, por zhvillimet e dhunshme që pasuan, e lanë në harresë. Zëra brenda Bashkimit Evropian e rikthyen në vitet 2000 duke e propozuar si një mekanizëm që do të rriste konkurrueshmërinë ekonomike të vendeve të rajonit, përfronte ekonomitë e tyre me ato të vendeve anëtare të BE-së,

do të rriste punësimin dhe mirëqenien e qytetarëve të Ballkanit dhe zbuste meritë historike mes vendeve të fqinje. Ndaj këtij projekti nuk mungojnë dhe qëndrimet kritike që e cilësojnë si një Jugosllavi të re. Kritikant shtohen në momentin që kjo marrëveshje Shqipëri-Serbi-Maqedoni e Veriut nuk merr parasysh kërkesat e Kosovës.



## Komisioni i Venecias rikthen përplasjet për gjuhën shqipe

Komisioni i Venecias ka vërejtje kryesisht për formën e zbatimit të ligjit në sistemin gjyqësor që, sipas raportit, tejkalon standardet e përcaktuara në Konventën-kornizë për mbrojtjen e pakicave kombëtare dhe Kartës evropiane për gjuhët rajonale dhe të pakicave



**SHKUP, 8 TETOR** - Drejtuesit e institucioneve janë të përmbajtur në vlerësimet lidhur me njoftimet se Komisioni i Venecias ka hartuar një mendim me vërejtje serioze lidhur me Ligjin për Gjuhët, që kryesisht ka të bëjë me përdorimin zyrtar të gjuhës shqipe. Komisioni, siç është publikuar në opinion, ka vërejtje kryesisht për formën e zbatimit të ligjit në sistemin gjyqësor që, sipas raportit, "tejkalon standardet e përcaktuara në Konventën-kornizë për mbrojtjen e pakicave kombëtare dhe Kartës evropiane për gjuhët rajonale dhe të pakicave". "Është një draft-version, pas vendimit përfundimtar pritet të publikohet nga fundi i vitit. Ata duan t'i shohim të gjitha reagimet që të mund të gjejnë zgjidhjen më të mirë. Gjithë atë që e propozojnë është në nivel të praktikave evropiane", thuhet aty. "Ne kemi thënë se do ta respektojmë çdo mendim që vjen nga ky komision, por në sqarimet tona do të japim argumente mbi rëndësinë që ka përdorimi i gjuhës, që ata të

mund ta formulojnë qëndrimin final", ka deklaruar kryeministri Zaev, duke theksuar rëndësinë që ka për vendin një ligj për gjuhët si e drejtë e garantuar me Kushtetutë. Nga Bashkimi Demokratik për Integrim që është pjesë e qeverisë gjithashtu nuk duan të paragjykojnë me vlerësimin e Komisionit të Venecias, por tërheqin vërejtjen se çfarëdo mendimi që mund të silltet, nuk duhet të shërbejë si alibi apo pretekst për moszbatimin e dispozitave të Ligjit për përdorimin e gjuhëve. "Ligji i Gjuhës është shtylla e Marrëveshjes së Ohrit ndërsa kjo marrëveshje është shtylla e stabilitetit dhe e prosperitetit të këtij vendi dhe çdo cenim i këtyre shtyllave cenon vendin. Por, unë mendoj se nuk duhet të paragjykojmë dhe të presim raportin final. Ne jemi në bashkëpunim me Komisionin e Venecias, na ka ndihmuar shumë në strategjinë e gjyqësorit dhe do të vazhdojmë të bashkëpunojmë, por vendimet finale për të

ardhmen e këtij vendi dhe raportet ndëretnike i miratojmë ne", ka deklaruar Bujar Osmani, zëvendëskryeministër dhe zëdhënës i BDI-së. Por, nga VMRO DPMNE-ja opozitare thonë se vërejtjet që kanë dalë nga Komisioni i Venecias konfirmojnë sipas saj pohimet e opozitës se ligji ishte miratuar për nevojat e partive në pushtet, dhe jo zgjidhje ligjore që mund të zbatohet në praktikë. "Qëndrimi ynë është se pazaret e kryeministrit Zaev, që të formojë qeverinë me miratim të ligjeve që nuk janë funksionale, tani rezulton me rekomandime nga Komisioni

i Venecias që paraqesin një goditje juridike për qeverinë. Presim që kryeministri Zaev të paktën të përmbushë premtimin e dhënë se të gjitha vërejtjet e Komisionit të Venecias do të merren parasysh për ndryshimin e ligjit që të mund të zbatohet", ka deklaruar Antonio Milloshoski, deputet i VMRO DPMNE-së. Megjithatë, nga opozita shqiptare thonë se ligji nuk mund të ndryshohet, por të avancohet. "E drejta për përdorimin e gjuhës shqipe në të ardhmen vetëm se mund të avancohet duke u rregulluar për-

dorimi i saj me Kushtetutë, pasi assesi nuk mund të ketë kthim prapa", ka deklaruar Arta Toçi nga Aleanca për Shqiptarët. Ligji për Gjuhët është miratuar në vitin 2018 pas polemikave të shumta mes pushtetit dhe opozitës, e cila vlerësonte se me këtë ligj Maqedonia e Veriut bëhet shtet dygjuhës duke rrënuar kështu karakterin unitar të shtetit. Gjuha shqipe në bazë të ligjit të miratuar përdoret në organet e pushtetit qendror, si në qeveri, Kuvend, pushtetin gjyqësor si dhe në komunat ku mbi 20 për qind e popullatës janë të entitetit shqiptar.

## Vilof von Carmon, raportuesja e re për Kosovën në Parlamentin Evropian

**STRASBURG, 8 TETOR** - Eurodeputetja gjermane, Vilof von Carmon-Taubadel, është raportuesja e re për Kosovën në Komitetin për Punë të Jashtme të Parlamentit Evropian. Carmon-Taubadel tashmë është e përfshirë në zhvillimet në Kosovë, pasi ka qenë shefe e misionit vëzhgues të Bashkimit

Evropian në zgjedhjet të cilat u mbajtën këtë fundjavë në vend. Eurodeputetja gjermane do të zëvendësojë Igor Sholtesin, i cili ka mbajtur këtë pozitë më parë në Parlamentin Evropian. Carmon-Taubadel gjithashtu vjen nga i njëjti grup parlamentar në Parlamentin Evropian të cilit i

përkiste Sholtes. Raportuesit e Parlamentit Evropian për Ballkanin Perëndimor janë përgjegjës për hartimin e raporteve vjetore që miratohen nga Komiteti për Punë të Jashtme të Parlamentit Evropian, të cilët më pas diskutohen në seanca plenare.



Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) ka shqyrtuar ankesat e partive politike

# PZAP-i hedh poshtë ankesat e partive, s'ka rinumërim të votave

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) ka hedhur, si të palejuara, ankesat nga PDK-ja, LDK-ja dhe koalicioni Nisma-AKR-PD për rinumërim të të gjitha fletëvotimeve nga zgjedhjet e 6 tetorit. Zyrtarët e këtyre subjekteve politike kanë pretenduar se gjatë procesit të numërimit të votave janë bërë disa gabime teknike të cilat do të mund të rregulloheshin vetëm me anë të rinumërimit të të gjithave votave

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 8 TETOR - Nuk do të ketë rinumërim të të gjitha fletëvotimeve nga zgjedhjet e 6 tetorit sepse Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) ka hedhur poshtë ankesën e PDK-së, të LDK-së dhe të koalicionit Nisma-AKR-PD, të cilat kanë kërkuar një gjë të tillë. Gjatë një seance mbajtur të martën, PZAP-ja i ka vlerësuar të pabaza ankesat e këtyre subjekteve politike. "Paneli

Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në seancën e mbajtur më datë 08. 10. 2019, ka shqyrtuar ankesën Anr. 350/2019, e paraqitur nga subjekti politik PDK, Anr. 351/2019, e paraqitur nga subjekti politik LDK dhe Anr. 353/2019, e paraqitur nga Koalicioni NISMA-AKR-PD, të datës 07. 10. 2019, me të cilat kanë kërkuar që të urdhërohet KQZ-ja ta bëjë rinumërimin e të gjitha fletëvotimeve në të gjitha vendvotimet e Republikës së Kosovës. Por, e njëjta ka marrë vendim t'i hedhë si të palejuara

ankesat e lartëtheksuara", është thënë në njoftimin për medie të PZAP-së. Zyrtarët e PDK-së dhe të LDK-së, të cilët, sipas rezultateve preliminare të zgjedhjeve, janë renditur pas LV-së, kanë treguar se gjatë procesit të numërimit të votave kanë ndodhur disa gabime teknike në formularët e KQZ-së. Kandidati për deputet nga LDK-ja dhe anëtari i shtabit zgjedhor nga ky subjekt politik, Florian Dushi, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se gabimi teknik ka ndodhur në shkallë vendi. "Ne kemi kërkuar

rinumërim në shkallë vendi. Se gabimi ka ndodhur në shkallë vendi. Pra, në të gjithë Kosovën. Fjala është për një gabim teknik, por që mund të ndikojë në rezultatin e zgjedhjeve. Gjatë përshkrimit të rezultateve në formular ka pasur lëvizje të renditjeve të partive. Ne kemi kërkuar rinumërim të votave dhe përshkrim në formularët e rinj", ka deklaruar anëtari i Shtabit Zgjedhor i LDK-së, Florian Dushi. Pothuajse arsyetim të njëjtë ka dhënë edhe zyrtari i PDK-së, Betim Gjoshi. Ai ka thënë se PDK-ja ka dërguar një ankesë në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) që t'ua kthejnë rezultatin me arsyetimin se janë bërë disa parregullsi gjatë numërimit të votave. "Ne kemi bërë një ankesë që të na kthehet rezul-

tati. KQZ-ja rezultatin e formularëve e ka shtypur në 24 rubrika e që kanë qenë 25 subjekte. Në shumicën e vendeve në Kosovë na kanë vendosur rezultatet e subjekteve të tjera politike. Ne vetëm kemi kërkuar rikthimin e rezultatit me rinumërim ose me procedura të tjera. Në gjithë Kosovën formulari është me gabim", ka thënë Gjoshi. Edhe kandidati për deputet i koalicionit Nisma-AKR-PD, Bilal Sherifi, ka thënë se zyra e tyre ligjore ka deponuar rreth 10 ankesa në PZAP. Ankesat e këtyre tri partive i ka komentuar edhe kandidatja për deputete e Lëvizjes Vetëvendosje, Albulena Haxhiu. Në profilin e vet në "Facebook" ajo ka shkruar se qytetarët kanë folur më 6 tetor dhe se vullneti i tyre do të jetësohet.

"Që nga mëngjesi kam pasur shumë mesazhe dhe telefonata nga qytetarë, miq dhe familjarë. Janë të shqetësuar lidhur me ndonjë tendencë për manipulim votash pas kërkesës për rinumërim. Qëndroni të qetë, mos u shqetësoni. Ne kemi personat përgjegjës që janë gardianët e vullnetit të qytetarëve. Pa dyshim se subjektet që nuk kanë marrë mbështetjen nga qytetarët, tentojnë të gjejnë shpëtim nga rinumërimi. Qytetarët kanë folur më 6 tetor. Vullneti i tyre do të jetësohet", ka shkruar Haxhiu.

Koalicioni AAK-PSD nuk është ankuar për procesin zgjedhor. Bartësi i listës së koalicionit AAK-PSD, Ramush Haradinaj, ka thënë se ky koalicion e pranon rezultatin e këtyre zgjedhjeve. "Koalicioni ynë e pranon rezultatin zgjedhor ashtu siç është nga KQZ-ja. Nuk kërkojmë rinumërim", ka thënë Haradinaj në një konferencë për medie.



## Partitë gjobiten me rreth 360 mijë euro për shkelje zgjedhore

PRISHTINË, 8 TETOR - Procesi zgjedhor për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 6 tetorit është vlerësuar i rregullt dhe transparent. Megjithatë, subjektet politike garuese në zgjedhje janë gjobitur nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) me rreth 360 mijë euro për shkelje të ndryshme brenda këtij procesi. Mul Desku, kryesues i Sekretariatit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia, ka bërë me dije për "Radion Evropa e Lirë" se deri në ditën e zgjedhjeve, më 6 tetor, janë gjobitur 13 subjekte politike. "Deri

më tani, sa iu përket ankesave për fazën e para fillimit të fushatës zyrtare të zgjedhjeve, për fushatën zgjedhore, për heshtjen zgjedhore dhe për ditën e zgjedhjeve, janë paraqitur apo PZAP-i ka pranuar 269 ankesa gjithsej. Shumë totale e gjobave të shqiptuara ndaj të gjitha subjekteve politike, për të gjitha ankesat që i theksova më lart, me përjashtim për ditën e zgjedhjeve që ende nuk janë shqyrtuar ankesat që kanë arritur dhe janë dorëzuar dje në PZAP, është 359 550 euro. Në këto gjoba përfshihet gjobitja e 13 subjekteve politike",

ka thënë Desku.

Partitë që janë gjobitur janë: Lidhja Demokratike e Kosovës, Partia Demokratike e Kosovës, Lëvizja Vetëvendosje, Lista Serbe, koalicioni Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe Partia Socialdemokrate, koalicioni Nisma, Aleanca Kosova e Re dhe Partia e Drejtësisë, Partia e Romëve të Bashkuar të Kosovës, Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës, Partia e Pavarur Liberale, Partia Liberale Egjiptiane, Vakati, Partia Demokratike Turke e Kosovës dhe Lëvizja për Gorën.



Flet për "Epokën e re", Fatmire Mulhaxha-Kollçaku

# Fitorja e Vetëvendosjes is

## - Qeveria Kurti do të jetësohet, vullneti i qytetarëve s'mund të ndryshohet

Nënkryetarja e Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, ka thënë se më 6 tetor qytetarët janë përcaktuar për ndryshim substancial në Kosovë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka theksuar se fitorja e Vetëvendosjes ka qenë e pritshme. Mulhaxha-Kollçaku ka bërë me dije se qeveria e udhëhequr nga Kurti do të jetësohet sepse nuk mund të ndryshohet vullneti i qytetarëve. Sipas saj, nuk është në favor të asnjë subjekti dhe të shtetit që të kemi zgjedhje të reja.

Mulhaxha-Kollçaku ka thënë se interesi i Kosovës dhe qytetarëve të saj është që sa më shpejt të formohet qeveria dhe proceset të ecin përpara



**EPOKA E RE** Shqipe HETEMI

**PRISHTINË, 8 TETOR** - Nënkryetarja e Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, ka thënë se në zgjedhjet e së dielës është ndëshkuar keqqeverisja e deritanishme në Kosovë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka thënë se më 6 tetor qytetarët janë përcaktuar për ndryshim substancial. Mulhaxha-Kollçaku ka deklaruar se qeveria Kurti do të jetësohet sepse nuk mund të ndryshohet vullneti i qytetarëve. Sepse, sipas saj, fitorja e Vetëvendosjes ka qenë e pritshme. Ajo ka thënë se çfarëdo tendence për ta pamundësuar qeverinë e udhëhequr nga Kurti do ta çojë vendin në zgjedhje.

Mulhaxha-Kollçaku ka vlerësuar se interesi i Kosovës dhe qytetarëve të saj është që sa më shpejt të formohet qeveria dhe proceset të ecin përpara. Ajo ka treguar se prioritetet e LV-së janë zhvillimi ekonomik dhe ndryshimi i gjendjes ekzistuese në vend. Mulhaxha-Kollçaku ka folur edhe për vazhdimin e dialogut me Serbinë, duke thënë se në këtë proces qeveria do t'i mbrojë shtetësinë, sovranitetin dhe integritetin e Kosovës. "Nuk do të bëjmë dialog të ngutshëm i cili domosdo duhet të përfundojë brenda natës, por do të jetë një dialog i bazuar në

argumente, që i sjellë të mira Kosovës dhe konfirmon njohjen nga Serbia", ka theksuar ajo.

**"Epoka e re":** Znj. Kollçaku, rezultatet preliminare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) e kanë nxjerrë Lëvizjen Vetëvendosje fituese të zgjedhjeve të parakohshme të 6 tetorit. Si e vlerësoni në përgjithësi këtë proces dhe a ka qenë i pritshëm rezultati i ngushtë në mes të LV-së dhe partisë së dytë, LDK-së?

**Mulhaxha-Kollçaku:** Dua t'i uroj dhe t'i falënderoj qytetarët e Republikës së Kosovës

për përcaktimin e tyre të drejtë duke votuar Lëvizjen Vetëvendosje. Ky përcaktim do të jetë në të mirën e çdo qytetari. Më 6 tetor u ndëshkua keqqeverisja e koalicionit PAN dhe iu dha mbështetja opozitës e cila mori shumicën e votave. Kjo do të thotë se është vullneti i qytetarëve për një ndryshim në Kosovë. Shumica e qytetarëve janë përcaktuar për një ndryshim substancial dhe Lëvizja Vetëvendosje është subjekti i parë me numrin më të madh të votave. Këtë e kemi pritur, por nuk ka qenë e lehtë kjo fitore në një shtet të kapur, mirëpo e kemi pasur me vete besimin e qytetarëve. Më 6

tetor u dëshmuua se ka shpresë që në Kosovë mund të vijë ndryshimi të cilin jemi duke e pritur tash e sa vjet. Ky është, në fakt, çlirimi i dytë sepse çlirimi i parë ishte në vitin 1999.

**"Epoka e re":** Megjithatë, të martën është kontestuar procesi zgjedhor sepse LDK-ja dhe PDK-ja kanë bërë anketa dhe kanë kërkuar rinumërim të votave në nivel vendi. Pas rinumërimit, a mund të ndryshojë rezultati?

**Mulhaxha-Kollçaku:** Pas përfundimit të procesit zgjedhor doli lideri i PDK-së dhe e pranoi rezultatin. Sa iu përket të

tjerëve nuk e di. Por ky rezultat do të rikonfirmohet në çdo situatë sepse qytetarët e Kosovës tash e 20 vjet kanë parë veç degradim nga të gjitha qeveritë që kanë udhëhequr Kosovën. Qytetarët janë përcaktuar për ndryshim dhe për Lëvizjen Vetëvendosje. Këtë vullnet të tyre nuk mund ta ndryshojë askush. Vetëvendosje gjithnjë ka qenë në mbrojtje të votës, pra nuk i ka mbrojtur vetëm votat e veta, por është angazhuar që të respektohet vullneti i qytetarëve pavarësisht se për cilën parti kanë votuar. Unë nuk dyshoj fare se rezultati përfundimtar kur të numërohen

# hte e pritshme

të jetë në favor të Lëvizjes meqë të pakënaqurit nuk kanë mundësi të votojnë për tjetërkënd. Presim që rezultatet përfundimtare ta rikonfirmojnë fitoren e Vetëvendosjes dhe fillimin e një qeverisje ndryshe dhe me duar të pastra. Detyra e parë e qeverisë Kurti do të jetë çrrënjësja e krimit dhe korrupsionit institucional.

**"Epoka e re":** Lëvizja Vetëvendosje, a i ka filluar negociatat me Lidhjen Demokratike për formimin e qeverisë së re?

**Mulhaxha-Kollçaku:** Jemi duke pritur numërimin e të gjitha votave, por lideri Kurti ka bërë me dije se do ta ftojë partinë që ishte në opozitë, LDK-në. Jemi të prirë që të bisedojmë me ata që kanë qenë në opozitë sepse të tjerët kanë keqqeverisur dhe e kanë humbur besimin e qytetarëve. Prandaj presim që pas numërimit të të gjitha votave, LV-ja dhe LDK-ja të ulen dhe të bisedojnë për formimin e qeverisë së re, së cilës do t'i prijë kryeministri Albin Kurti.

**"Epoka e re":** Ju keni preferenca për të bashkëqeverisur me LDK-në, por nëse kjo nuk do koalicion me ju, atëherë a mund të presim një koalicion të LV-së me AAK-në dhe minoritetet?

**Mulhaxha-Kollçaku:** Nuk dua që tani të lëshohem në këto analiza sepse e kemi bërë të qartë preferencën tonë. Jemi të interesuar për të bashkëqeverisur me LDK-në dhe partitë minoritare, përveç Listës Serbe.

**"Epoka e re":** Ka rrezik që të mos formohet qeveria Kurti?

**Mulhaxha-Kollçaku:** Çfarëdo tendence eventuale për ta pamundësuar qeverinë e udhëhequr nga Kurti do ta çojë vendin në zgjedhje të reja. Natyrisht se pas atyre zgjedhjeve qeveria do të formohet vetëm nga Lëvizja Vetëvendosje. Kështu që nuk besoj se është në favor të asnjë subjekti, më së paku të shtetit të Kosovës, që të kemi zgjedhje të reja. Interesi i qytetarëve dhe shtetit të Kosovës është që sa më shpejt të formohet qeveria Kurti dhe të ecin proceset përpara.

**"Epoka e re":** Të gjithë jemi të vetëdijshëm se Kosova ndodhet në një gjendje jo të mirë dhe e presin shumë sfida si në aspektin e brendshëm, po ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Do të mund qeveria Kurti

ta përmirësojë gjendjen në vend dhe t'i tejkalojë me sukses këto sfida, përfshirë këtu dialogun me Serbinë, agjendën evropiane, sundimin e ligjit, zhvillimin ekonomik e të tjera?

**Mulhaxha-Kollçaku:** Jemi të vetëdijshëm ndaj sfidave që na presin. Kemi trashëguar një gjendje shumë të rëndë, mirëpo duke pasur parasysh programin tonë qeverisës, kryeministrin Albin Kurti, numrin e madh të kuadrove dhe duke qenë të hapur për njerëzit e tjerë, është e qartë që ekspertët tanë do të bëjnë ndryshime substanciale në shëndetësi, në arsim dhe në të gjitha segmentet e tjera. Edhe sa i përket dialogut jemi shumë kredibilë dhe me përkrahjen e bashkësisë ndërkombëtare Serbia do të jetë në një pozitë jo të favorshme përballë nesh. Serbia është ajo që e ka nisur luftën dhe që ka bërë krim në Kosovë, prandaj na ka shumë borxh. Qeveria Kurti do të zhvillojë një dialog ndryshe dhe në të mirë të Kosovës. Qeverisja jonë do ta ndryshojë gjendjen për të mirë në vend dhe do ta shpërblejë besimin e qytetarëve. Të jeni të sigurt se Kosovën e presin ditë më të mira.

**"Epoka e re":** Do të mund të arrihet marrëveshja Kosovë - Serbi në këtë mandat të Kurtit?

**Mulhaxha-Kollçaku:** Prioritetet tona janë zhvillimi ekonomik dhe ndryshimi i gjendjes ekzistuese në vend. Nuk do të bëjmë dialog të ngutshëm i cili domosdo duhet të përfundojë brenda natës, por do të jetë një dialog i bazuar në argumente, që i sjellë të mira Kosovës dhe konfirmon njohjen nga Serbia. Do të kemi njerëz kredibilë në ekipin negociator. Dialogu është i pashmangshëm, por në një format krejt tjetër. Fillimisht do t'i shqyrtojmë të gjitha marrëveshjet e arritura të cilat i kanë sjellë favore vetëm Serbisë dhe kjo përfundimisht do të ndryshojë. Është e qartë se fillimisht do të bisedojmë me serbët e Kosovës dhe të gjitha komunitetet e tjera për t'i mbështetur nevojat e tyre, por jo ata të cilët kanë qenë të ndikuar nga Beogradi dhe kanë bërë obstrukcione ndaj Kosovës dhe kanë penguar anëtarësimin e saj në organizatat ndërkombëtare. Qeveria Kurti, në dialogun me Serbinë, do t'i mbrojë shtetësinë, sovranitetin dhe integritetin e Kosovës.

## Kurti takohet me ambasadorin Kosnett, flasin edhe për dialogun

**PRISHTINË, 8 TETOR** - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka pritur në takim ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë, Philip Kosnett. Sipas komunikatës së Vetëvendosjes, në këtë takim miqësor ambasadori Kosnett ka shprehur kënaqësinë e vet për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor, pjesëmarrjen e lartë të qytetarëve dhe ka uruar kryetarin Kurti për një fushatë që adresoi shqetësimet e votuesve. "Ambasadori Kosnett ka treguar interesim të veçantë në përparimin kundër korrupsionit, për ekonominë dhe për përparimin në dialogun me Serbinë, drejt arritjes së një marrëveshje gjithëpërfshirëse që do të sillte stabilitet dhe paqe të qëndrueshme në rajon", është thënë në komunikatë. Ndërsa kryetari i Vetëvendosjes, Albin Kurti, e ka siguruar ambasadorin Kosnett se do të jetë kryeministër për të gjithë qytetarët e Kosovës. Ai e ka njoftuar

ambasadorin se konsolidimi i brendshëm i Kosovës me shtetndërtim demokratik, sundim të ligjit, zhvillim ekonomik dhe progres shoqëror është prioritet që do ta zbatojë, meqë edhe nevojat e qytetarëve e vullneti i tyre i shprehur në këto zgjedhje ishte për këtë. Kurti ka thënë se dialogu do të fillojë me serbët e Kosovës, nga poshtë-lart për zhvillim e integrim të serbëve qysh në javën e parë. Ndërsa në muajin e parë, Kurti ka thënë se nevojitet takim me Borrelin, përfaqësuesin e ri të lartë të BE-së për Siguri dhe Politikë të Jashtme, si dialog me Brukselin për dialog me Serbinë sepse, sipas tij, dialogu me Serbinë duhet të jetë i përgatitur mirë e me parime të qarta. Ai ka thënë se paraprakisht duhet të mbyllet kapitulli i 33 marrëveshjeve të mëhershme, përkatësisht vlerësimi i zbatimit dhe i ndikimit të tyre. Kurti ka theksuar se nuk duhet të vonohen, por as nuk kanë arsye të nxitohen e të bëjnë gabime që mund t'i kushtojnë vendit.



edhe votat e diasporës dhe votat me kusht do të jetë në favor të Vetëvendosjes.

**"Epoka e re":** Nuk prisni që pas këtyre ankesave të konstatohet se ka pasur gabime dhe lëshime?

**Mulhaxha-Kollçaku:** Të gjithë e kanë pranuar se ka qenë një proces zgjedhor i rregullt me disa shkelje të vogla të cilat janë evidentuar dhe çdo shkelës duhet të ndëshkohet. Lëvizja Vetëvendosje gjithnjë është angazhuar që të respektohet vullneti i votuesve. Ne jemi angazhuar që të ketë dalje më të madhe sepse e kemi ditur se dalja më e madhe do

# Mustafa takohet me ambasadorin Kosnett



PRISHTINË, 8 TETOR - Kryetari i LDK-së, Isa Mustafa, është takuar të martën me ambasadorin e ShBA-së në Kosovë, Philip Kosnett. Gjatë këtij takimi është diskutuar për procesin zgjedhor të së dielës. Me këtë rast, kryetari Mustafa ka shprehur mirënjohjen dhe falënderimin e veçantë për mbështetjen e vazhdueshme që ShBA-ja i ka dhënë Kosovës. Sipas komunikatës së LDK-së, ambasadori Kosnett ishte i kënaqur me atë se sa mirë ka shkuar procesi zgjedhor, me

daljen e lartë në votime dhe për faktin se kishte aq shumë përqendrim në çështjet për të cilat shqetësohen votuesit. Ai ka thënë se pret një përqendrim të ripërtërirë në përparim kundër korrupsionit, në ekonomi dhe në dialog me Serbinë drejt arritjes së një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse që do të sillte stabilitet dhe paqe të qëndrueshme në rajon. Në këtë takim të pranishëm kanë qenë nënkryetarët Agim Veliu, Vjosa Osmani, Lutfi Haziri dhe anëtarja e Kryesisë, Vlora Dumoshi.

## Agjencia Kundër Korrupsionit: Nuk ka pasur konflikt interesi në Provimin e Noterisë

PRISHTINË, 8 TETOR (ER) - Ministria e Drejtësisë (MD) e Republikës së Kosovës nëpërmjet një komunikate për medie të martën ka bërë me dije se ka pranuar opinionin e Agjencisë Kundër Korrupsionit (AAK), përmes të cilit është konstatuar se nuk ka pasur konflikt të mundshëm të interesit në procesin e Provimit të Noterisë. "Në opinionin e AAK-së me numër protokoll 06-2118/19, thuhet se, pas hapjes dhe inicimit të rastit, janë ndër-

marrë të gjitha hetimet, analizimet dhe vlerësimet për pretendime për konflikt të mundshëm të interesit në procesin e provimit për Noter dhe pas vlerësimit të rrethanave lidhur me rastin konkret, AAK ka ofruar këtë opinion: 'Është identifikuar, është deklaruar dhe është shmangur konflikti i interesit nga Anëtarët e Komisionit për dhënien e Provimit të Noterisë, në pajtim me nenin 6, paragrafi 3 i Udhëzimit Administrativ MD-

NR. 01/2019 për mënyrën e dhënies dhe programin e Provimit për Noterinë', thuhet në opinionin e AAK-së", është theksuar në komunikatën e MD-së. Më tutje është thënë se, ndër të tjera, opinionin e AAK-së thotë se procesverbalet kanë dëshmuar se personat e apostrofuat për konflikt të interesit janë deklaruar dhe zëvendësuar me kohë. "Është nënshkruar deklarata e fshehtësisë nga Anëtarët e Komisionit për dhënien e

Provimit të Noterisë, në pajtim me nenin 13, paragrafi 2 i Udhëzimit Administrativ MD Nr. 01/2019, për mënyrën e dhënies dhe programin e provimit për Noterinë si dhe janë zëvendësuar me të tjerët, të gjithë Anëtarët e Komisionit që kanë deklaruar konflikt të interesit me ndonjë nga pjesëmarrësit në provim", thuhet në opinionin e AAK-së. Ky opinion nga institucioni kompetent për vlerësimin e gjendjes ose jo të konfliktit të interesit i hedhë

poshtë të gjitha dyshimet eventuale dhe konfirmon legjitimitetin e plotë të reformës që është duke u zbatuar", është thënë në komunikatën e MD-së. Ministria e Drejtësisë është e angazhuar për t'u ofruar qytetarëve të Republikës së Kosovës një sistem noterial profesional, efikas dhe të qasshëm, që është në shërbim të drejtëpërdrejtë të tyre dhe qasjes në drejtësi si një nga komponentët themelore të sistemit të drejtësisë.



## KQZ-ja përfundon numërimin e votave të rregullta

PRISHTINË, 8 TETOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka përfunduar numërimin e të gjitha votave të rregullta nga zgjedhjet e 6 tetorit. Sipas rezultateve të votave të rregullta të publikuara në uebfaqen e KQZ-së, Lëvizja

Vetëvendosje prin me 25.48 për qind apo 202 968 vota. Pas saj është renditur LDK-ja me 24.82 për qind apo 197 702 vota, kurse PDK-ja është e treta me 21.24 për qind apo 169 211 vota, koalicioni AAK-PSD është subjekti i katërt me

11.57 për qind apo 92 149 vota. Ndërsa koalicioni Nisma-AKR-PD është nën prag zgjedhor prej 5 për qindësh me 39 495 vota apo 4.96 për qind. Tash pritet edhe numërimi i votave me kusht dhe atyre të diasporës.

Fajtorët për Korrupsionin e Kosovës 2019

Publikuar më: 8.10.2019 21:22:12

Rezultatet Preliminare	Numri i votave	Përqindja e votave të rregullta
126. LËVIZJA VETËVENDOSJE	202,968	25.48%
124. LDKJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS	197,702	24.82%
120. PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS	169,211	21.24%
125. AAK-PSD KOALICIONI 100% KOSOVË	92,149	11.57%
129. GRUPEJA LIDHTA	39,495	4.96%
122. NISMA SOCIALDEMOKRATË - ALBANIA KOSOVA E RE - PARTIA E DREJTËSISË	2,877	0.36%
124. KOALICIONI VAKUT	6,581	0.83%
127. KOSOVA DEMOKRATIKU TËRË PARTIJA	5,072	0.64%
121. PARTIA LIBERALE EKSPERTISE	4,877	0.61%
128. NOVA DEMOKRATIA STANJKA	0	0%
123. PARTIA E VETËVENDOSJES	0	0%

# ShBA-ja dhe BE-ja presin nga qeveria e re rifillimin e dialogut me Serbinë

Zyrtarët e ShBA-së dhe të BE-së presin formimin e shpejtë të Qeverisë së re të Kosovës. Ata kanë bërë me dije se presin që qeveria e re ta vazhdojë dialogun për normalizim të marrëdhënieve me Serbinë dhe të jetë e angazhuar për forcimin e demokracisë dhe paqes në vend

**EPOKA E RE** **Faton DERMAKU**

PRISHTINË, 8 TETOR - Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Evropian presin që Qeveria e re e Kosovës ta vazhdojë dialogun me Serbinë. Një zëdhënës i Departamentit Amerikan të Shtetit ka thënë se ShBA-ja pret që udhëheqja e re në Kosovë t'i rifillojë menjëherë bisedimet me Serbinë drejt një marrëveshjeje për normalizimin e marrëdhënieve. "Ne mirëpresim mundësinë që të punojmë me një qeveri të re pro dialog, që të jetë e angazhuar për forcimin e demokracisë dhe paqes, për drejtësi dhe mirëqenie për të gjithë qytetarët e Kosovës. Ne kemi qenë të qartë për pritshmërinë tonë, që udhëheqja e re e Kosovës të jetë e gatshme t'i rifillojë menjëherë bisedimet me Serbinë dhe të punojë drejt një marrëveshjeje për normalizimin e marrëdhënieve", ka thënë zëdhënësi i Departamentit Amerikan të Shtetit për "Zërin e



Amerikës".

Edhe shefja e politikës së jashtme e Bashkimit Evropian, Federica Mogherini, dhe komisionari për zgjerim i BE-së, Johannes Hahn, presin që aktorët politikë të Kosovës pas zgjedhjeve t'i vazhdojnë obligimet ndërkombëtare që kanë marrë.

Dy zyrtarët, që merren drejtpërdrejt me çështjet e rajonit të Ballkanit Perëndimor, kanë vlerësuar se presin formimin sa më të shpejtë të Qeverisë së Kosovës. Sipas tyre, kjo është e rëndësishme në mënyrë që Kosova të vazhdojë të punojë në mbështetje të zhvillimit ekonomik dhe social, në sundimin e ligjit, në zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit me BE-në dhe në dialogun për normalizimin e

marrëdhënieve me Serbinë. "Presim që të gjithë aktorët politikë të mbeten të përkushtuar ndaj këtyre proceseve që janë të rëndësishme për të ardhmen e Kosovës, për përparim në rrugën evropiane dhe, më e rëndësishmja, për përfitimin e qytetarëve të Kosovës dhe të gjithë rajonit", kanë vlerësuar Federica Mogherini dhe Johannes Hahn përmes një deklarate për medie. Bisedimet për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi janë ndërprerë qëkur Kosova u ka vënë taksë prodhimeve të importuara nga Serbia në nëntor të vitit të kaluar.

Përkundër thirrjeve të ShBA-së dhe të Bashkimit Evropian për heqjen e kësaj takse dhe zhblokimin e dialogut,

autoritetet në Kosovë nuk kanë ndryshuar qëndrim.

Zyrtarët në Serbi, në anën tjetër, kanë marrë qëndrim për mosvazhdimin e dialogut derisa të hiqet taksa.

Edhe ambasadori i Britanisë së Madhe në Prishtinë, Nicholas Abbott, dhe ai i Gjermanisë, Christian Heldt, ka thënë të martën se presin që pas përfundimit të procesit të numërimit të votave sa më shpejtë të formohet qeveria e re. Të dy diplomatët perëndimorë kanë lavdëruar Kosovën për procesin zgjedhor të mbajtur më 6 tetor. Abbotti ka thënë se sipas rezultateve preliminare, qytetarët e Kosovës kanë votuar për ndryshim. "Rezultatet janë të qarta. Kosova ka votuar për

ndryshim dhe tash pret formimin e një qeverie të re dhe stabile, që do të mund të merret me çështjet e rëndësishme me të cilat është duke u ballafaquar vendi. Unë mezi pres bashkëpunimin me qeverinë e re", ka shkruar Abbott në llogarinë e vet në "Facebook". Kurse diplomati gjerman ka thënë se tani përgjegjësia i takon politikës në të mirë të ardhmes së vendit. "Ne mezi presim formimin e shpejtë të një qeverie të re dhe bashkëpunim të ngushtë për të vazhduar më tej. Qytetarët kanë dhënë mandatin, tani përgjegjësia i varet politikës në të mirë të së ardhmes së vendit. Mezi pres të rikthehem në punë", ka shkruar Heldt në llogarinë e vet në "Twitter".

## DnV-ja e vlerëson të qetë dhe me parregullsi të vogla procesin zgjedhor



PRISHTINË, 8 TETOR - Demokracia në Veprim (DnV) ka shpallur para medieve deklaratën preliminare për monitorimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 6 tetorit.

Artan Murati nga DnV-ja ka thënë se kjo deklaratë preliminare i paraprin raportit që do të publikohet më vonë në kuadër të vëzhgimit të këtyre zgjedhjeve.

"Në përgjithësi, koalicioni i OJQ-ve vendore Demokracia në Veprim konsideron se zgjedhjet janë zhvilluar në frymë të qetë dhe demokratike, pa ndonjë parregullsi ose incident serioz që do të mund ta cenonte integritetin dhe besueshmërinë e publikut ndaj procesit zgjedhor në tërësi", ka thënë ai,

duke shtuar se zgjedhjet janë administruar sipas standardeve më të larta dhe në harmoni me kornizën ligjore. "Dita e zgjedhjeve, përkundër faktit se ka pasur parregullsi të vogla, është zhvilluar e qetë. Nuk ka pasur incident serioz që do ta diskreditonte procesin zgjedhor dhe do ta humbiste besimin qytetar në procesin zgjedhor të 6 tetorit", ka thënë ai.

DnV-ja e ka vlerësuar punën e KQZ-së dhe Komisioneve Komunale Zgjedhore si shumë të mirë. "Dita e zgjedhjeve në përgjithësi ka qenë proces i rregullt ku nuk janë shfaqur parregullsi të mëdha, por gjithsesi vazhdon të ketë probleme që i kemi hasur edhe në të kaluarën", ka deklaruar Murati.

# 200 persona certifikohen si trajnerë brenda kompanive



GIZ-i gjerman, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, ka bërë shpërndarjen e 200 certifikatave për pjesëmarrësit të cilët janë kualifikuar si trajnerë brenda kompanive në Kosovë. Në emër të Ambasadës Gjermane në Prishtinë, Anja Becky, ka deklaruar se sa i takon arsimin dhe aftësimin profesional, Kosova, e përkrahur nga GIZ-i, ka bërë disa përparime në këtë drejtim. Sipas saj, kompanitë private në Kosovë kanë shprehur gatishmërinë që të investojnë në burimet e tyre sa i përket arsimin dhe aftësimin profesional

## /Epoka e re/

**PRISHTINË, 8 TETOR** - Organizata gjermane GIZ ka organizuar konferencën me temë "Arsimi dhe aftësimi profesional". Në këtë konferencë është thënë se për arsimin dhe aftësimin profesional duhet përkrahje më e madhe nga të gjitha institucionet. Në kuadër të kësaj konference është mbajtur edhe paneli

diskutues dhe është bërë shpërndarja e certifikatave për 200 pjesëmarrësit e kualifikuar si trajnerë brenda kompanive. Aktiviteti për trajnimin e 200 personave është organizuar nga projekti "Rinia, punësimi dhe aftësimi profesional" përmes organizatës gjermane GIZ në emër të qeverisë gjermane në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë.

Në emër të Ambasadës Gjermane në Kosovë, Anja Becky, ka deklaruar se sa i takon arsimin dhe aftësimin profesional, Kosova, përkrahur nga GIZ-i, ka bërë disa përparime. Sipas saj, kompanitë private në Kosovë kanë shprehur gatishmërinë që të investojnë në burimet e tyre sa i përket arsimin dhe aftësimin profesional. "Në fillim mbështetja gjermane është fokusuar duke dhënë pajisje,

duke trajnuar drejtorë dhe mësimdhënës, mirëpo në vitet e fundit kemi kaluar në bizneset private dhe kompanitë private. Dëshira e kompanive private është që t'i investojnë burimet e tyre në sektorin privat. 200 kompani kanë marrë pjesë në trajnim dhe 234 në sektorët e përgjithshëm në Kosovë janë duke u certifikuar e që janë trajnuar nga projekti i GIZ-it. 20 instruktorë janë trajnuar edhe

në sektorin e ndërtimit. Këto kompani jo vetëm se kanë dëshiruar, mirëpo janë edhe të pajisura me trajnerë adekuatë", është shprehur Becky.

Ndërsa Valbona Fetiu-Mjeku nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë ka thënë se në Kosovë asnjëherë nuk ka pasur përkrahje të mjaftueshme nga institucionet përgjegjëse për arsimin dhe aftësimin profesional. Ajo u ka bërë thirrje bizneseve vendore që nxënësve të certifikuar në arsimin dhe aftësimin profesional t'u japin më shumë hapësirë në bizneset e tyre. "Edhe pas gjithë këtyre viteve nuk kemi arritur të kemi atë që është menduar që të jenë Qendra Kombëtare, mirëpo janë shkollat dhe qendrat më të mira që janë deri tani. Në çdo hap GIZ-in e kemi pasur edhe në planin strategjik që e kemi hartuar së bashku, por edhe me donatorë të tjerë", është shprehur Fetiu-Mjeku.

Udhëheqësi i njërit prej projekteve të organizatës gjermane, Klaus Bader Labarre, ka thënë se GIZ-i përmes projekteve të veta ka parë vullnetin e sektorit privat për të qenë aktiv në arsimin dhe aftësimin profesional të të rinjve. Sipas tij, përmes projektit "Rinia" janë trajnuar 200 persona prej 20 kompanive të ndryshme. "Si projekt i GIZ-it, shohim një ndryshim të qartë në sjelljen e vullnetit të sektorit privat për ta marrë rolin aktiv në arsimin dhe aftësimin profesional. Më shumë se 200 trajnerë prej 20 kompanive të ndryshme fuqishëm janë duke e mbështetur këtë aspekt", është shprehur Labarre.

## OAK-u dhe ATK-ja diskutojnë për procesin e trajtimit tatimor për sektorin e ndërtimit

**PRISHTINË, 8 TETOR** - Oda e Afarizmit e Kosovës (OAK) ka pritur në një takim menaxhmentin e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Ekrem Hysenaj, koordinator i projektit, Sami Salihu, drejtor i shërbimeve të sektorit të tatimpaguesve dhe Nevahi Rexhepi, menaxher i projektit. Qëllimi i këtij takimi ka qenë informimi rreth një procesi të cilin Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) është duke e implementuar. Procesi ka të bëjë me trajtimin tatimor në sektorin e ndërtimit në Kosovë, proces ky që ka rezultuar nga hulumtimet paraprake mbi performancën e sektorit përkatës, rreth të cilit ATK-ja në muajin prill ka draftuar planin. Kryetari i OAK-ut, Skënder

Krasniqi, ka falënderuar përfaqësuesit e ATK-së për takimin, duke shtuar se kjo odë është e interesuar që të bashkëpunojë për zgjidhjen e problemeve të identifikuar e me të cilat bizneset vazhdimisht janë duke u përballur. Ndërsa Ekrem Hysenaj nga ATK-ja ka thënë se esenca e projektit është njoftimi i palëve të interesit në lidhje me ndryshimet dhe aplikimet e reja që do të bëhen për sektorin e ndërtimit, duke i dhënë rëndësi primare edukimit të tatimpaguesve. Ai i ka informuar të pranishmit për disa statistika të cilat ATK-ja i ka nxjerrë për periudhën janar-dhjetor 2018 dhe të hyrat që kanë gjeneruar nga ky sektor. Në anën tjetër, Sami Salihu ka



thënë se sektori i ndërtimit ka disa rregulla të veçanta të cilat aplikohen, andaj edhe monitorimi do të bëhet përmes një qasje të re që njihet si qasje holistike, nga lart-poshtë, e cila do të ketë

shtrirje horizontale. Ai tutje vazhdoi që ATK-ja është e gatshme që vazhdimisht t'i ndihmojë tatimpaguesit. Kurse Hysni Zogaj ka vlerësuar gatishmërinë e ATK-së për të ofruar sesione

informuese për bizneset, duke theksuar se ato duhet të përkrahen më shumë, pasi janë duke u përballur me probleme shumë të mëdha e për të cilat OAK-u është duke punuar tash e tre vjet.



# Banka Botërore: Në Kosovë ka përparim ekonomik, por jo mjaftueshëm



Drejtor i Bankës Botërore në Prishtinë, Marco Mantovanelli, ka thënë se në Kosovë ka përparim ekonomik, por jo mjaftueshëm pasi, sipas tij, 60 për qind e popullsisë së të rinjve në Kosovë nuk janë aktivë në tregun e punës. "Në Kosovë ka përparim, por jo mjaftueshëm kur e shohim faktin se 60 për qind e popullsisë e të rinjve në Kosovë (moshë pune) nuk janë aktivë në tregun e punës. Pra, nuk punojnë ose nuk kërkojnë vende të punës. Kështu që shumë më shumë duhet krijuar rritje ekonomike që hap më shumë vende pune", është shprehur Mantovanelli

**EPOKA  
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 8 TETOR** - Gjatë prezantimit të raportit të rregullt ekonomik për Ballkanin Perëndimor nga Zyra e Bankës Botërore në Kosovë është konstatuar se për vitin 2019 rritja ekonomike në Kosovë parashikohet të arrijë 4 për qind krahasuar me 3.8 për qind në vitin 2018. Sipas kësaj zyre, kjo rritje do të

ndodhë për shkak të konsumit, eksporteve, shërbimeve dhe investimeve.

Drejtori i Bankës Botërore në Prishtinë, Marco Mantovanelli, ka thënë se deficitin e përgjithshëm buxhetor pritet të mbetet nën 3 për qind të Produktit të Brendshëm Bruto dhe brenda kufirit të rregullës fiskale prej 2 përqindësh që përjashton shpenzimet kapitale të financuara nga të ardhurat e privatizimit dhe insti-

tucionet financiare ndërkombëtare. Sipas tij, performanca pakëz e ulët në të hyra, krahasuar me planin, do të mbikompensohet me nënëkzekutim të konsiderueshëm të projekteve kapitale. Kurse shpenzimet për mbrojtje sociale me shënjestrim të dobët mbeten të larta dhe vazhdojnë ta kufizojnë hapësirën fiskale. "Në Kosovë mesazhi është që ka përparim, por jo mjaftueshëm kur e shohim faktin

se 60 për qind e popullsisë së të rinjve në Kosovë (moshë pune) nuk janë aktivë në tregun e punës. Pra, nuk punojnë ose nuk kërkojnë vende të punës. Kështu që shumë më shumë duhet krijuar rritje ekonomike që hap më shumë vende pune", ka thënë Mantovanelli.

Më tutje, ai ka thënë se Banka Botërore nuk përkrah projekte energjetike me thëngjill, siç është projekti "Kosova e Re" edhe pse, sipas tij, ka mungesë të energjisë elektrike në Kosovë. Ai ka treguar se ky projekt është ende në lojë por, sipas tij, Banka Botërore përkrah projekte energjetike vetëm të ripërtërishme. "Projekti 'Kosova e Re' edhe më tutje është në lojë ose në vazhdim, edhe pse nuk e dimë çfarë do të jetë rezultati. Nëse dështon ky projekt, pasojat janë që Kosova duhet të përzgjedhë skenarë alternativë. Personalisht shoh skenarë që, siç thashë edhe më herët, ofrojmë

mbështetje për opsionet e ripërtërishme", është shprehur ai.

Në fund Mantovanelli ka përgëzuar Kosovën për zgjedhje transparente, por ka kërkuar që të formohet sa më parë qeveria e re. Ndërsa Asli Senkal, ekonomiste në Bankën Botërore për Kosovë, ka deklaruar se pjesëmarrja në fuqinë punëtore vazhdon të jetë e ulët përkundër shkallës së lartë të papunësisë. "Në tremujorin e dytë të 2019-s papunësia shënoi rënie 4.1 pikë përqindje, nga e njëjta periudhë e vitit të kaluar, për shkak të punësimit më të lartë, por edhe të pjesëmarrjes më të ulët në fuqinë punëtore. Në tremujorin dytë të 2019-s shkalla e punësimit u ngrit ngaqë u krijuan më shumë vende pune në Kosovë, mirëpo shkalla e papunësisë edhe më tutje mbetet më e larta në rajon pavarësisht prej zhvillimeve pozitive në tremujorin e dytë 2019", ka thënë Senkali.

## Fillon asfaltimi i disa rrugëve në Polac

SKENDERAJ, 8 TETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, së bashku me nënkryetarin Nuredin Lushtaku, drejtoreshën e Urbanizmit, Sanije Ahmeti, inxhinierë dhe bashkëpunëtorë, kanë dalë në fshatin Polac për ta parë nga afër asfaltimin e segmenteve të rrugëve që ka filluar. Me këtë

projekt do të trajtohen rreth 3 km rrugë në këtë fshat. Me këtë rast, Jashari ka thënë se janë duke vazhduar për t'i përmbushur kërkesat e banorëve të këtij fshati. "Në fshatin Polac po vazhdon asfaltimi i segmenteve të rrugëve, ku do të trajtohen rreth 3 km rrugë me asfalt. Së bashku me nënkryetarin Nuredin

Lushtaku dhe bashkëpunëtorë pamë nga afër punimet që po bëhen. Kështu po vazhdojmë përmbushjen e kërkesave të banorëve të Polacit. Tani banorët e kësaj pjese do të kenë infrastrukturë rrugore më të mirë. Së bashku me qytetarët tanë do të punojmë çdo ditë, pa u ndalur, në çdo pjesë të vendit!", ka thënë Jashari.



# Zyrtarë të KFOR-it vlerësojnë pozitivisht procesin zgjedhor në Kaçanik

Komandanti i grupit shumëkombësh perëndim të KFOR-it dhe të kontingjentit italian në Kosovë, kolonel Daniele Pisani, ka uruar popullin e Kosovës për një proces elektorale të organizuar dhe të zhvilluar jashtëzakonisht mirë

KAÇANIK, 8 TETOR (ER) - Komandanti i grupit shumëkombësh perëndim të KFOR-it dhe të kontingjentit italian në Kosovë, kolonel Daniele Pisani, bashkë me përfaqësues të tjerë të KFOR-it italian dhe të LMT-së, kanë vizituar Komunën e Kaçanikut, ku janë pritur nga nënkryetari Ylber Bajra. Në takim, nënkryetari Bajra ka njoftuar përfaqësuesit e KFOR-it për zhvillimet aktuale në Komunën e Kaçanikut dhe për prioritetet

të cilat i ka kjo komunë për ngritjen e mirëqenies së qytetarëve. Ndërsa komandanti i grupit shumëkombësh perëndim të KFOR-it dhe të kontingjentit italian në Kosovë, kolonel Daniele Pisani, ka uruar popullin e Kosovës për një proces elektorale të organizuar dhe të zhvilluar jashtëzakonisht mirë, duke theksuar pjekurinë e madhe të qytetarëve të Kosovës ku, sipas tij, fitues më i madh është demokracia qytetare.



## Rifunksionalizohet pika informuese për turistë në Prizren

Prizren, 8 tetor (ER) - Drejtorja e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik ka bërë rifunksionalizimin e pikës informuese për turistë në afërsi të Stacionit të Autobusëve në Prizren. Komuna e Prizrenit ka njoftuar se kjo pikë informuese më parë ka qenë e vendosur në lagjen "Bazhdarhane" dhe që nga viti 2017 ka mbetur jashtë funksionit për shkak të vendosjes në lokacion të gabuar. "Duke pasur parasysh zonat më të frekuentuara nga turistët dhe nevojës për t'u dhënë informacione atyre, është vendosur që kjo pikë informuese për turistë

të rifunksionalizohet dhe të zhvendoset në afërsi të Stacionit të Autobusëve si zonë më e qasshme. Në këtë pikë do të punohet sipas orarit të rregullt 08:00-16:00, ku turistët do të mund të informohen lidhur me ofertat dhe pakot turistike që ofrohen në Komunën e Prizrenit. Kjo është pika e tretë informuese për turistë në Komunën e Prizrenit pas asaj që gjendet në objektin e Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe pikës tjetër që gjendet në rrugën "Farkatarët", ka njoftuar Komuna e Prizrenit.



## Shërbimi i urgjencës në Gjilan bëhet me dy autoambulanca të reja

GJILAN, 8 TETOR (ER) - Komuna e Gjilanit i ka dorëzuar të martën Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) dy autoambulanca të reja të cilat janë investim krejtësisht i kësaj komune në shumën mbi 100 mijë euro. "Jemi sot këtu për t'i dorëzuar dy autoambulanca në Gjilan dhe është investim 100 për qind i Komunës së

Gjilanit, i planifikuar në mënyrën më të mirë prej Drejtorisë për Shëndetësi. E përgëzoj drejtorin Xhemajli dhe drejtorin e QKMF-së, Fejzulla Berisha, për punën e mirë që po e bëjnë në ndihmë të qytetarëve. Është projekt tepër i rëndësishëm dhe uroj që të përdoren në mënyrë më të mirë dhe të ruhen për shkak

se është investim nga taksat e qytetarëve", tha nënkryetari i komunës, Arbër Ismajli, pas dorëzimit zyrtar të këtyre dy autoambulancave. Ndërsa drejtori i Shëndetësisë në Gjilan, Selami Xhemajli, ka thënë se krahas këtyre dy autoambulancave janë duke investuar në tërë shërbimin shëndetësor në këtë komunë.



# ALBIN KURTI, KOSOVA DHE E ARDHMJA



Shkruan: Bedri ISLAMI

Kosova, nga e diela në mbrëmje, ka një kryeministër të ri, Albin Kurtin, dhe një forcë politike që do të drejtojë vendin, Lëvizjen Vetëvendosje!

Albin Kurti, një ndër liderët e Lëvizjes Studentore të vitit 1997, më pas i angazhuar në Zyrën e Adem Demaçit në Prishtinë, qershor 1998 e deri në arrestimin e tij në javët e fundit të luftës në Kosovë, i burgosur politik në burgjet serbe, i cili u lirua pas ndërhyrjes së drejtpërdrejtë të ish-presidentit francez Jak Chirak, krijuesi i një lëvizje politike që shpejt do të kthehej në forcë politike, deputeti rebel dhe shpeshherë edhe brenda sallës së Kuvendit, i drejtpërdrejtë në artikulet e tij, gjithnjë me idenë e bashkimit të shqiptarëve në një shtet të vetëm; kundërshtari më i ndjeshëm ndaj lëvizjeve politike të Presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, me të cilin ende nuk kanë gjetur asnjë pikë takimi të përbashkët; i revoltuari me qeverinë e tij, kushdo të ketë qeverisur, por edhe me shtetin shqiptar dhe, i beftë në lidhjet politike të krijuara, do të jetë kryeministri i ri i Kosovës.

Pavarësisht fitores së tij të çastit të fundit, me një diferencë të ngushtë ndaj LDK-së së Isa Mustafës dhe Vjosa Osmanit, e para grua që kandidon deri tani për postin kryeministër, fitore që ka edhe përkrahjen e dhënë nga diaspora, ku ai gjeti mjaft nga dishepujt e tij, që mund të kenë bërë edhe diferencën e duhur, Albin Kurti e sheh veten dhe , Kosova e sheh atë , si njeriun që mund të bëjë kthesën e duhur, të sjellë një frymë ndryshe në qeverisje, të ketë përballje tjetër lloj në bisedimet e zgjatura me shtetin serb dhe faktorin

ndërkombëtar; të krijojë një qeveri të së drejtës, për njerëzit e me njerëzit.

Vota e ditës së diel, më shumë se sa mbështetje ndaj një programi të caktuar, ishte një votë ndëshkuese ndaj gjithë një klase politike, shumë nga të cilët të ardhur nga lufta, menduan se mund ta qeverisnin Kosovën si ia kishte qejfi, të ngushtonin lirinë e të tjerëve, duke rritur përfitimet e tyre. Ndëshkimi i tyre, gjithsesi i merituar dhe në kohën e duhur, ka të bëjë edhe me sorollatjen qeverisëse, krijuar shpesh herë nga ngushtësia e momentit se sa nga aleanca burimore, të ngritura përmes vizionit të përbashkët apo synimeve të përbashkëta. Ndëshkimi erdhi pikërisht në zgripin e një qeverisje, të cilën, as shpatullat e forta të Ramush Haradinajt nuk mund ta ngrinin.

Por, nuk ishte vetëm ky shkaku i fitores së LV-së dhe të Albin Kurtit. Në një shkrim të para tri ditëve kemi shënuar se të gjitha forcat politike në Kosovë janë provuar në qeverisjen e saj dhe të gjitha kanë qenë pranë dështimit, ose edhe kanë dështuar. E vetmja forcë politike që nuk ishte provuar qëndronte tek Lëvizja Vetëvendosje dhe lideri i saj karizmatik, Albin Kurti. Kishte ardhur koha që, në një mënyrë ose në një tjetër, drejtimi i Kosovës t'i besohej një forcë të re dhe një lideri tjetër, i cili nuk kishte qëndruar në pas-skenë edhe kur kishte qenë lideri i opozitës, as kur ishte menduar se ndarja do e dobësonte atë dhe as kur kishte hapur në të njëjtën kohë dy fronte të përballimit; njërin në Kosovë dh tjetrin në Shqipëri. Përkrahja ndaj tij, megjithëse jo aq sa pritej, e ngushtë në numra dhe e shpërndarë në disa forca politike, me siguri, do e bëjë atë më të vëmendshëm, më të matur në hapat që do të hedhë, më racional dhe programues më të saktë për të ardhmen.

Sidoqoftë, fitorja e tij, nuk ishte dhuratë dhe as e papritur. Për të arritur deri këtu, Albin Kurti, me dorë të fuqishme dhe nganjëherë të

hekurt, e ktheu Lëvizjen e tij në një forcë politike të organizuar, të drejtuar mbi disa parime koncentruese dhe duke e kthyer në një lëvizje masive protestuese. Përvoja e tij në Lëvizjen studentore të para vitit 1997 dhe në demonstratat e saj në tetorin e këtij viti, e kanë bindur atë se ndryshimet nuk mund të vijnë dhe të realizohen duke heshitur, pritur apo përmes një rruge të mëndafshtë. Aso kohe, së bashku me liderët e tjerë studentorë, Bujar Dugolli, Muhamet Mavraj, Driton Lajçi dhe rektorin e Universitetit të Prishtinës, Ejup Statovci, e kthyen lëvizjen e tyre në një parafjalë të luftës që do të vinte dhe, dashje pa dashje, kjo përvojë masovike, ka gjetur shprehjen e saj edhe në këto vite kur LV-ja ishte forcë politike opozitare, që nuk ndalej as para hedhjes së molotovëve në sallën e kuvendit, përplasjes dhe debatit të pashterur politik.

VV është sot forca politike më e organizuar në Kosovë dhe kjo ka sjellë fitoren e saj. Ajo, e shtrirë tek të rinjtë, ka sjellë besimin tek ndryshimi dhe te një ekip i ri drejtuesish politikë e shtetërorë.

Albin Kurti është lideri më karizmatik politik i shqiptarëve në Kosovë. Megjithëse ai nuk arriti të sigurojë mbi 30 për qind të votave të dhëna, çka ishte pritur edhe nga institucione jashtë Kosovës, mori të drejtën e krijimit të qeverisë së re, për të cilën ka premtuar dy gjëra themelore: do të jetë qeveri efikase, e vogël në numër, por e zhërvjellët në veprim dhe, ndëshkimin e së keqes së bërë para qeverisjes së tij, pra ndëshkimin e korrupsionit, vjedhjeve, nepotizmit, politikave të prapështa. Ai ka meritën e tij të padiskutueshme në të gjithë këto zhvillime dhe në fitoren e së dielës. Njeri i lexuar, njohës i mirë i disa filozofive politike të kohës, artikulet e saktë i mendimit të tij politik, debatues i fuqishëm, i pakompromis, atë nuk e ndalën drejt pushtetit as disa lidhje të tij, të pakuptueshme, me figura që bartin mbi vete forca ekstrem-

iste të besimit radikal islam, e po ashtu, as ndarja, disa muaj më parë, e një grupi bashkëthemelues, që krijuan më pas një partizë, drejtuar nga Shpend Ahmeti.

Në fushatën e zhvilluar Albin Kurti u konfirmua si lideri kryesor, pasi edhe filozofia e tij në këtë fushatë ishte më e kapshme se të tjerët, më e drejtpërdrejtë, më pranë njerëzve, të cilët shpesh herë ishin lodhur nga premtimet e atyre që kishin qeverisur deri të dielën. Ai e moderoi fjalorin e tij gjatë fushatës, duke theksuar pikërisht ato që kishte mohuar deri asaj kohe, duke nënvizuar përkushtimin e tij dhe lojalitetin ndaj Kosovës, ndaj asaj që kishte ndodhur, duke njohur disa vlera të mohuara më herët, duke afruar qëndrimet e tij edhe me forca politike që normalisht duhej të ishin kundërshtarë të saj, si me LDK, duke moderuar qëndrimin ndaj figurës së Ibrahim Rugovës dhe, atë që kishte pasur themelore para fushatës, bashkimin me shtetin shqiptar, e kaloi mjeshtërisht në plan të dytë dhe, si duket nga deklaratat e para të tij, do vazhdojë ta shtyjë në etazhet e tjera të politikës së tij, si ka ndodhur edhe me qeveritarë të tjerë.

Kurti ndodhet para tri ngjarjeve kryesore: krijimin e qeverisë së re, dhe për këtë ia ka bërë hapin e parë duke iu drejtuar forcës së dytë politike në vend, LDK-së, dhe, nëse kjo ndodh, do të jetë hera e parë që , dy forca politike mund të krijojnë vetë qeverinë, pa pasur domosdoshmëri edhe faktorin politik serb, çka, edhe ashtu mund t'i imponohet nga ndërkombëtarët; bisedimet me Serbinë, të cilat do të jenë të domosdoshme, edhe nga që është vënë si primare e shumë shteteve; taksa 100 për qind ndaj prodhimeve të ardhura nga Serbia, çka përbën edhe një thembër akiliane në qeverinë e ardhshme. Të tria këto ngjarje madhore në pamjen e parë, kanë fare pak të bëjnë me drejtimin konkret të qeverisë, uljen nga retë teorike dhe të mendimit në realitetin praktik, por, në fakt, janë të lidhura

ngushtë me njëra tjetrën. Do të mundet Kurti të përballojë presionin ndërkombëtar, të eliminojë probleme të krijuara nga e shkuara politike qeverisëse, apo do të gjejë pikërisht këtu mbështjellësen e justifikimeve, çka ka ndodhur shpesh herë në politikën shqiptare të Kosovës? Do të mundet të jetë po aq atdhetar i vendosur edhe në tryezën e bisedimeve, sa është shfaqur në diskutet politike?

Si ka vërejtur me të drejtë analisti i njohur politik, Bislim Elshani, "Nëse mbrëmë, flamujt amerikanë dhe gjermanë, gjatë festimit, nuk i kishte për shfaqje popullizmi e vardisje ndaj të mëdhenjve, por një mesazh politik simbolik, atëherë kjo nënkupton se edhe për bisedimet me Serbinë do të këshillohet me të mëdhenjtë, pavarësisht premtimeve elektorale!

Albin Kurti është i njohur edhe në Shqipëri për qëndrimet e tij politike dhe lidhjet me forca të ndryshme apo të kundërta me ideologjinë e Lëvizjes së tij politike. Ai, sidomos kohët e fundit, ka shpallur kundërshtitë dhe ndeshjet e tij edhe me kryeministrin e shtetit shqiptar, Edi Rama, por edhe afërsitë me forca opozitare. Do të ndikojë kjo në marrëdhëniet mes dy shteteve të të njëjtit komb apo do të jenë primare çështjet madhore? Do të ketë të njëjtën rritje dhe dega e tij në shtetin shqiptar dhe shefi i ri i qeverisë së Kosovës do të jetë edhe lideri i tyre politik, si ka ndodhur deri tani?

Rrugë të vështirë ka përballë vetes Albin Kurti. Ai po merr drejtimin e qeverisë në një moment të rëndë shumëdimensional, por askush tjetër nuk kishte kohën për të marrë këtë drejtim.

Koha është e Albin Kurtit. Është koha për të nisur një kapitull të ri në politikën e Kosovës, e cila, do të jetë e vështirë dhe në të cilën, ndëshkimi i së keqes do të ketë vendin e tij të rëndësishëm. Tani, sytë e të gjithëve, brenda e jashtë Kosovës, mbështetës e kundërshtarë, janë drejt tij. Ai ka kohën e tij për të drejtuar Kosovën dhe për të sjellë ndryshimin.

# DASH-i urdhëron ambasadorin Sondland të mos dëshmojë në Kongres



Ukrainës Zelenskiy, Sondland dhe Kurt Volker, i cili ishte i dërguar i posaçëm amerikan në Ukrainë, u takua me udhëheqësin e Ukrainës e figura të tjera politike.

Informatori shkruan se, sipas bisedave të zbardhura të atyre takimeve e të rrëfyera nga zyrtarë amerikanë, ambasadorët Volker dhe Sondland i kanë këshilluar udhëheqësit ukrainas se si t'u qasen kërkesave që presidenti i kishte bërë atij". Duke folur për gazetaret të hënën në Shtëpinë e Bardhë, Trumpi përsëriti se biseda e tij me Zelenskiy ishte e përkryer. Në përgjigje të interesimit të gazetarëve, presidenti tha se nuk ndihej i shqetësuar nga njoftimet për një informator të dytë mbi këtë çështje. Trumpi tha se telefonata e tij me udhëheqësin e Ukrainës ishte miqësore, duke shtuar se nuk kishte pasur presion.

Komisionet e Zbulimit, Punëve të Jashtme dhe Mbikëqyrjes së Dhomës së Përfaqësuesve që janë në krye të hetimit kanë zhvilluar seanca dëgjimore dhe kanë bërë kërkesa zyrtare për dokumente nga anëtarët e administratës Trump dhe avokati personal i presidentit, Rudy Giuliani.

Të hënën ata lëshuan një kërkesë të re drejtuar sekretarit të Mbrojtjes, Mark Esper dhe drejtorit në detyrë të zyrës së menaxhimit dhe buxhetit Russell Vought për dorëzimin deri më 15 tetor të dokumenteve në lidhje me vendimin e Trumpit për ta ndaluar ndihmën ushtarake për Ukrainën.

Një pjesë e hetimit përfshin shqyrtimin nëse vendimi i Trumpit për ta ndaluar ndihmën ushtarake për Ukrainën ishte i lidhur me kërkesën e tij për një hetim ndaj Joe Bidenit dhe djalit të tij. Ndërkohë autoritetet në Ukrainë nuk kanë gjetur asnjë provë për përfshirjen e tyre në korrupsion.

Tri komisione të Dhomës së Përfaqësuesve kishin planifikuar ta merrnin në pyetje të martën në mëngjes Sondlandin në seanca me dyer të mbyllura, por avokati i Sondlandit tha se një urdhër i Departamentit të Shtetit e detyroi klientin e tij të mos paraqitej

Departamenti i Shtetit nuk po i jep Kongresit mesazhet e ambasadorit amerikan në Bashkimin Evropian që, siç tha ai, janë të rëndësishme për hetimin. "Kongresi jo vetëm se po privohet nga dëshmia e tij, por ne jemi në dijeni se ambasadori ka mesazhe telefonike dhe e-maile në një pajisje personale, që i është dhënë Departamentit të Shtetit, megjithëse ne i kemi kërkuar të na i japë. Departamenti i Shtetit nuk po lejon që ne t'i marrim ato", u tha Adam Schiff gazetarëve. "Ato mesazhe janë shumë të rëndësishme për hetimin për ngritjen e akuzave për shkakimin e presidentit", shtoi Schiff.

Në një postim në "Twitter" që pasoi këtë zhvillim presidenti shkruante: "Do të doja ta dërgoja ambasadorin Sondland për të dëshmuar, një njeri me të vërtetë të mirë dhe amerikan i madh por, për fat të keq, ai do të

dëshmonte përpara një gjykate krejtësisht të kompromentuar, që injoron standardet e drejtësisë e të ligjit, ku të drejtat e republikanëve janë hequr dhe ku faktet nuk lejohen për publikun".

Të hënën presidenti Trump e kritikoi sërish hetimin duke e quajtur "një skemë mashtruese" të demokratëve, të cilët, siç tha, nuk duan që ai të fitojë një mandat të dytë si president.

Sondland është bërë një figurë e rëndësishme e hetimit që po kryen Kongresi, për shkak të përpjekjeve të tij që Ukraina të angazhohej në hetimin e kundërshtarit të mundshëm të Trumpit në garën presidenciale, ish-nënpresidentin Joe Biden dhe djalin e tij, Hunter Biden. Sipas ankesës së një informatori, e cila nxiti hetimin ndaj presidentit, thuhet se një ditë pas bisedës telefonike të Trumpit me presidentin e

në seanca me dyer të mbyllura, por avokati i Sondlandit tha se një urdhër i Departamentit të Shtetit e detyroi klientin e tij të mos paraqitej. "Ai është ambasador në detyrë dhe punonjës i Departamentit të Shtetit dhe duhet ta zbatojë urdhrin e tyre", tha avokati i tij Robert Lusk.

Seanca me dyer të mbyllura ishte pjesë e hetimit për ngritjen e akuzave ndaj presidentit Trump. Në një reagim kryetari i Komisionit të Zbulimit në Dhomën e Përfaqësuesve, Adam Schiff, tha se

WASHINGTON, 8 TETOR - Administrata e presidentit Donald Trump urdhëroi të martën ambasadorin amerikan në Bashkimin Evropian, Gordon Sondland, që të mos paraqitet përpara Kongresit për t'u marrë në pyetje lidhur me komunikimet në mes të Trumpit dhe zyrtarëve ukrainas që janë bërë shkak për një hetim për shkakimin e presidentit.

Tri komisione të Dhomës së Përfaqësuesve kishin planifikuar ta merrnin në pyetje të martën në mëngjes Sondlandin

## Marrëveshja për Brexitin, gati e pamundur

LONDËR, 8 TETOR - Burime të Qeverisë britanike thanë se marrëveshja për Brexitin, apo për daljen e Britanisë nga Bashkimi Evropian, "është në thelb e pamundur". Ky vlerësim, sipas BBC-së, pason një bisedë telefonike të kryeministrit të Britanisë, Boris Johnson, me kancelaren gjermane Angela Merkel. Thuhet se Johnsoni foli për propozimet për marrëveshje që i ka dorëzuar te BE-ja, porse Merkel e bëri të qartë se marrëveshja e bazuar në ato propozime "ka fare pak gjasa". Sipas BBC-së, Merkel, po ashtu, tha se

marrëveshja nuk do të jetë kurrë e mundur derisa Irlanda e Veriut nuk mbetet në unionin doganor. Një zëdhënës i Merkelit tha se ata nuk i zbulojnë bisedat konfidenciale.

Presidenti i Këshillit Evropian, Donald Tusk, bëri një postim në "Twitter", duke iu drejtuar Johnsonit: "Ajo çfarë është në rrezik nuk është të fituarit e një loje të marrë të fajit. Në rrezik është e ardhmja e Evropës dhe e Mbretërisë së Bashkuar, si dhe siguria dhe interesat e njerëzve tanë".

Johnsoni ka thënë vazhdimisht se

Mbretëria e Bashkuar do të largohet nga BE-ja në afatën e 31 tetorit, me ose pa marrëveshje.

Një nga çështjet kryesore që e pengon marrëveshjen është e ardhmja e kufirit midis Irlandës Veriore - e cila është pjesë e Mbretërisë së Bashkuar dhe do ta linte BE-në me pjesën tjetër të vendit - dhe Republikës së Irlandës, e cila është pjesë e BE-së. Paraardhësjja e Johnsonit, Theresa May, ka arritur një marrëveshje me BE-në për këto çështje, por marrëveshja e saj është refuzuar tri herë nga Parlamenti britanik.



# PESHËRËNDA VLERËMADHE, VOTË E NËNËS



ISA FERIZAJ

Me datën 06 tetor 2019, populli i Kosovës, me të drejtë vote, iu drejtua kutive të votimit, për të zgjedhur përfaqësuesit e vet në organin më të lartë të pushtetit kushtetues, në Kuvendin e Kosovës.

Kësaj here zgjedhjet në Kosovë patën një të veçantë, sepse ato ishin të parakohshme.

Kultura politike, por edhe ajo morale, njerëzore që i karakterizoi këto zgjedhje, që nga dita e shpalljes së tyre e, deri në daljen e rezultatit të atij votimi shembullor e më se demokratik, pse jo edhe një model i shkelqyer edhe për shtete me demokraci në 'mohën' e tretë, të botës së sotme.

Kosova, shteti më i ri i Europës, shembulli dhe modeli më i përkryer se si mund të organizohen, kryhen e mbyllen zgjedhjet e sistemit qendror në një vend!

Ende, edhe sot e kësaj dite, diskutohet për ndershmërinë e zgjedhjeve të fundit për president, në kryekalanë e demokracisë botërore, SH.B.A. Kjo dukuri e, as të tjera si kjo, nuk ndodhen në asnjë palë zgjedhjesh në shtetin e ri e të brishtë të Kosovës së pas-mëvetësisë së saj.

Në këto radhë që po shkruaj, jo pa një farë frymëzimi të veçantë, dua të ndalem tek 'Vota e Nënës'!

Gjithandej në këto zgjedhje u panë nëna në moshë të thyer, bile edhe mbijnëshekullore, siç ishte ai rasti i një nëne 106 – vjeçare që votoi në Ferizaj.

E habitshme, se si një pjesë e nënave tona, këtyre krijueseve e rilindsëve të botës njerëzore, në rastin konkret, të popullit e të kombit tonë, ndonëse në pjesën e mbrame të rrugëtimit

të tyre jetësor, nuk u tërhoqën nga detyrimi i tyre ndaj dheut të të parëve, dheut të tyre e, të bijëve të tyre; ato nuk u treguan indiferente ndaj këtyre zgjedhjeve, çka edhe mund t'i 'justifikonte', por e çuan mesazhin e amanetin e tyre deri në kutitë e votimit, për ta bashkuar me ëndrrat e amanetet e perealizuara të breza e breza nënave të tjerë, ikur nga kjo jetë. Ëndrrat e nënave janë kryeëndërra, sepse nga ato lindin të gjitha ëndrrat e një populli, a kombi, ëndrra jete, lirie, përparimi,

hyjnore, se si u dha atyre të drejtën dhe mundësinë për ta bërë dheun ku ato na lindën, 'djepin' ku ato na perkunden e na rriten e, ku pranë të të cilit na kënduan këngët e zemres së Kombit tonë; na futen në zemer e në gjak, dashurinë për këtë 'djep', të cilin së bashku me bashkëshortët e me baballarët e fëmijëve të tyre, e quajten edhe 'Atdhe' (dheu i atit), qellim ky si për ta bërë të qartë amësinë dhe atësinë tonë kombëtare.

Parë në këndvështrimin filo-

së Atmëmëdheut tonë në sytë tanë, kemi ushqyer edhe rritur vlerat tona njerëzore.

Ja, sa 'e rëndë' është vota e një nëne shqiptare, për fatet tona në rrugëtimit tonë historik!

E tillë, peshërendë sa kjo tokë është edhe vota e nënës Ramize, në Cernicë të Gjilanit! Aty, në atë votë të kësaj nëne zemermdadhe, afro 80-vjeçare, është 'vota' – 'Po, me Shqipërinë!' – Jo, me Serbinë!, e heroit të Kosovës e të shqiptarisë, Ramiz Cernica; aty, në atë votë është sakrificat e mbi-

edhe 'votës' së luftës së gjyshit të tij, komandant çlirimtar e fitimtar i famëmadhes lavdiplote, U.Ç.K. të udhëhequr nga kryekomandanti, legjendari i asaj lufte e ushtrie heroike, Adem Jashari.

Nënë Ramizja e Cernicës së burrave të urtë, trima, heroik e të pathyeshëm të asaj treve me lavdi, e pava tek po e hidhte atë votën e saj në kutinë e votimit dhe, përnjëherë lexova në rrudhat e ballit të saj se si jeta kishte skalitur portretin e një nëne të urtë deri në urtësi,



zhvillimi, arsimimi, kulturimi e civilizimi njerëzor e shoqëror. Sa rëndë peshon një votë nëne! Jam i bindur se ajo votë ka brenda peshën e dashurisë së pamatshme njerëzore të një nëne; po ashtu, besoj se vota e një nëne shqiptare ka brenda vlerën që s'matet me asgjë, atë të lindjes e të trashëgimisë së gjithëformshmë të kombit e kulturës së tij; ajo votë, e kuptoj se është e ngjizur në mënyrën më kuptimplote me kalkun gjuhësor të shqipes, 'Mëmëdhe' (dheu i mëmës), i mëmave tona, kalk ai që defton qartë se si u dha kryevlera këtyre nënave njerëzore, fisnike, deri në hamendësi,

zofik, Atmëmëdheu ynë është edhe i atit, edhe i mëmës, çka e shpreh shumë bukur edhe gjuhësisht, por edhe moralisht e shkencërisht, dialektikën e filozofinë e formimit të Kombit tonë.

Kështu pra, Atmëmëdheu ynë është prindërsia jonë e parë natyrore e 'biologjike' sepse me 'gjakun' e tij kemi mbushur zemrat tona, me 'bukën' e tij kemi ushqyer jetët tona, me 'ujin' e tij kemi shuar etjet e gjithëshfarshme në rrugëtimit tonë të gjatë e të stërmundimshëm, me bukuritë e tij, kemi ushqyer ndjesitë e shpirtin, zemrat e arsytë tonë, me madhësinë e shpërfaqjes

jetesa e gjysmës së kombit tonë nën robërinë çnjerëzore mbi njëshekullore serbo-sllave; aty është vota 'ideal' dhe 'përkushtim' e një lufte guerilëse heroike e vetëmohuese edhe e asaj me armë në dorë për lirinë e Kosovës, e djalit të saj, Ismetit dhe e gjithë bijëve shqiptarë që mbushën radhët e UÇK-së; në atë votë, që mos qoftë e fundit, as për këtë nënë, por as për nënat e tjera moshëthyer shqiptare, shikova ëndrrat e ndezura të nipërve të saj, por edhe shkëndijat e atyre ëndrrave të para, në formë dëshirash, të sternipit të saj, Akilit, që lindi e po rritet në Kosovën e lirë, falë

shpirtmadhe deri në madhësi, e kthjelltësi, në vendimmarrjet e saj në sherbim të Atdheut, edhe përmes votes!

Tek ai akt solemn rikuptova se si ajo mishëronte në qenien e vetëdijen e saj, atë që është në të vertetë Nëna shqiptare legjendare, që vjen që nga mitet, legjendat, gojëdhënat, tregimet e realitetet e jetës shqiptare, për të na e dhënë e, për të na mësuar që ta përcjellim në brezat që po rritim, amanetin e detyrimin që kemi ndaj Dheut të babait e të nënës, amanet e detyrim nga i cili askush që i thotë vetes 'shqiptar', s'mund të shmanget.

NAGUIP MAHFOUZ

# DHOMA NR. 12

**Përktheu: Flurans ILJA**

I zoti i bujtinës kujton, si një foto që asnjëherë nuk harrohet, se si një ditë një grua erdhi dhe rezervoi një dhomë veç për 24 orë. Ora ishte fiks 10:00 paradite.

Pamja kaq trallisëse e pranisë së seksit opozitar që i afrohej, krejtësisht e pashoqëruar, e bën bujtinarin t'ia mballosë sytë ngultazi, kureshtar.

Njëtrajtësisht, ajo dukej një grua e shkëlqyer mbresëlënëse, me shtatin e shtalbtë, finesën e tipareve dhe mprehtësinë e shikimit. Ajo u ndal te sporteli, duke qëndruar trupdrejt nën mantelin e kuq dhe kapelën e bardhë. Nuk kishte asnjë dokument identifikimi, nuk punonte gjëkund dhe as që ishte e martuar. Për më tepër, dukej si e ndarë nga burri, apo e ve.

Quhej Bahiga al-Dahabi dhe vinte nga Mansura e Deltës.

Bujtinari regjistroi krejt informacionin e nevojshëm dhe e përçasi drejt punonjësit të sportelit.

Sportelisi në krye të saj, duke mbajtur valixhen, më e rënda që kishte mbajtur ndonjëherë gjatë gjithë karrierës së tij, e orientoj gruan drejt dhomës nr. 12, në bujtinën e tyre të vogël. Pastaj u kthye pas një gjysmë ore, i habitur në fytyrë. Kur menaxheri e pyeti se çfarë ndodhi, ai vegoi hazër-xhevap:

"Ajo është një femër shumë e çuditshme!"

"Shpjegohu, çfarë nënkupton me këtë?" u shtëllis menaxheri. Sportelisi filloi të rrëfente se si ajo i kishte kërkuar të zbulonte shtratin nga mbulesa, batanijet dhe çarçafët, duke i hedhur në cep të dhomës. Përsa i përket krevatit, i kishte kërkuar ta lëviznin së bashku jashtë dhomës, me justifikimin se kishte fiks se mos nga hapësira e krijuar poshtë vendit të fjetjes, fshihej një njeri. Ai i tha se frika e saj ishte e ekzagjeruar sepse asnjëherë nuk kishin ndodhur incidente të tilla që nga koha kur hoteli ishte bërë Bismilah. Por ajo këmbëngulte, kështu që iu bind vullnetit të saj. "Duhet të kishte ardhur urgjentisht tek unë, zullap", tha bujtinari. Sportelisi kërkoi të falur, duke thënë se megjithëse kërkesa e saj ishte e çuditshme, ai nuk kishte përdredhur asnjë nga detyrat që hoteli kishte si detyrim të përmbushë. Më tej e përmbylli historinë me fjalët se si ajo e kishte urdhëruar t'i hapte të gjitha kanatat e dollapit duke i lënë njashtu. Zëri i saj tregonte se kishte frikë nga dikush që mund të fshihej ose nën krevat, ose në dollap. Kështu që i plotësoi të gjitha urdhrat e saj, i buzëqeshi ashtu si ai di të buzëqesh gjithmonë dhe u largua. "Pjesa më e çuditshme është se ajo dukej grua azgane dhe trime", cilësoi bujtinari.

Pas pak e pyeti punonjësin e vet: "A të dha ndonjë bakshish?"

"Një peçe të plotë", u mburr tjetri.

"Natyrisht, ajo nuk është femër e rëndomtë, ndaj nuk besoj se do të kemi ndonjë turbullirë", plotësoi menaxheri. "Më shpuri rruga përball derës së saj të mbyllur, kur po shkoja për në lavanteri, dhe dëgjova një zë të lartë të hasdisur brenda në dhomë", tha sportelisi.

"Ishte e vetme?" - "Gjithmonë, zëri i saj i dalldisur dëgjohej i vetëm".

"Gjithë dynjaja bëjnë kështu", tha menaxheri. "Zaten, vetëm pse ti flet me vete nuk do të thotë se je i lajthitur". Sportelisi tundi kryet pa thënë kurrëgjë. Tjetri e pyeti, "A je në gjendje të rikujtosh gjësend çka thoshte?"

"Jo, përveç shprehjes: Nuk është e rëndësishme!" Menaxheri dha të kuptoj për mbylljen e muhabetit. Një grimë më vonë, pasi shënoi diçka në regjistër, shtoi në drejtim të tjetrit: "Duhet të jesh vigjilent, kjo është detyra jonë, për çdo rast".

Gumëzhinë bubullima dhe bujtinari e treti vështrimin te qielli përtej dritares ku gjeti mbulesa të dendura reshë. Moti kishte qenë i ftohtë me reshje të kohë-paskohshme. Saktësisht në orën 1:00 të drekës, grua telefonoi prej dhomës nr. 12.

"A mundet të porosis diçka për të ngrënë?" pyeti ajo. "Ne nuk kemi ushqim në bujtinë, por është një gjelltoje matanë xhadesë, çfarë dëshironi zonjë?"

"Perime të pjekura me mish pule, plus pilaf me tasqebap, gati nja një kile shishqebap të pjekur, një tas me sallatë orientale, mish qengji të mbështjellë me pite të ngrohta, ëmbëlsira dhe portokall".

Megjithëse i zoti i bujtinës i porositi të gjitha gjellërat që ajo urdhëroi, gati sa nuk luajti nga fiqiri prej sasisë së ushqimeve. Vetëm mishi i pjekur mjaftonte për gjashtë persona. "Kjo qenka fiks jo vetëm me frikën, por edhe me llupësinë", i tha vetes. "Sidoqoftë, do të dal gjatë pasdites e do t'i hedh një sy dhomës".

Ushqimi mbërriti. Një orë më vonë i zoti i gjelltores përkarshi erdhi t'i merrte paratë. Menaxheri nuk i rezistoi tundimit t'ua hidhte një sy pjatave. Të gjitha ishin të bëra xixë, përveç disa kockave të kruara mirë dhe pak salcë të mbe-tur. I shkau truri nga e gjithë kjo skenë, asgjë tjetër përveç kësaj gruaje, mënyrës se si ajo vështronte dhe vepronte, e shtynë në ngasje. Nuk mund të thoshte se ajo s'ishite e bukur, përkundrazi ajo zotëronte një forcë tërheqëse jo të zakonshme. Ishte diçka e frikshme në raport me atë grua, së bashku me gjërat kurioze, madje nënshtruese, që të ngujonin.

Mbi të gjitha e kishte parë vetëm një herë, momentin e parë, atë ditë kur ajo i kishte lënë ndjesinë familjare që vinte së bashku me fytyrën,

që mbartte prushin vetjak të kujtimeve të vjetra.

Drejt tij po vinin një burrë dhe një grua. "A qëndron këtu zj. Bahiga al-Dahabi?" pyeti burri. Bujtinari pohoi dhe telefonoi që të pyesë nëse zonja dëshironte që vizitorët të ngjiteshin lart në dhomë. Dukshëm, njerëzit ishin nga sërë e lartë, të kamur nga pikëpamja materiale. Era uturinte fuqishëm përjashta, duke i bërë shandanët të kërcenin në sallën e pritjes. Menjëherë papritur tetë persona të tjerë ia behën, katër gra dhe katër burra, duke përsëritur të njëjtën pyetje: "A qëndron këtu zj. Bahiga al-Dahabi?" Përsëri bujtinari telefonoi për lejimin e vizitorëve të rinj. Grupi, me pamje krenare, që ishin të së njëjtës sërë me çiftin e mëparshëm, u ngjiten drejt dhomës Nr. 12. Tash bëheshin dhjetë vizitorë. Ndoshta farefis prej së njëjtës familje, ose thjesht miq, apo gjindja dhe kushërinj të përzier. Çfarëdoqoftë të ishte arsyeja, nuk kishte asnjë dyshim që Madam Bahiga nuk është një zonjë e rëndomtë. "Si përzgjedhi bujtinën tonë xhanëm?" pyeste veten i shqetësuar. Zallahia u shpërnda menjëherë nga kthina e barit, ndërsa kamarjerët e hotelit servirin si pehlivan, gota çaji lart e poshtë, qyshkur menaxheri po mendohej të fiksonte disa nga fytyrat e të porsaardhurve. Por, mendoi me vete se gjëja më e mirë do të ishte ta fshinte nga truri, gjithçka në raport me Bahiga al-Dahabin. Të nesërmen ajo do të ishte veç një nga ato qindra fytyra të humbura në kujtesën e bërë lëmsh, të hotelit të vogël.

Përball tij u fanit një grua rreth të pesëdhjetave, që zotëronte një ekuilibër dhe sjellje të tejskajshme. "A qëndron këtu zj. Bahiga al-Dahabi?" Kur ai iu përgjigj po, ajo i tha: "Ju lutem, a mund ta njoftoni se doktoresha është këtu". Kontaktoi damën në telefon. Një grimë më tej, i shtytur nga një arsye urgjente, e pyeti të porsaardhurën: "Cili është tamam profesioni juaj doktoreshë?"

"Gjinekologe", u përgjigj ajo. Vërejtje se tjetra nuk ishte prezantuar me emrin e saj, por me titullin e profesionit. A po e viziton damën kinse nga aftësia profesionale? Apo mos vallë Bahiga al-Dahabi vuan nga ndonjë sëmundje femërore? Ose, ndoshta, është thjesht me barrë? Nuk kishte kohë t'u jepte përgjigje të gjitha këtyre pikëpyetjeve që e kishin mbështjellë tërësisht, kur një burrë shkurtabiq dhe i shëndoshë, nursëz, u shpërfaq para tij. Duke u prezantuar si Jusuf Qabil, biznesmen ndërtimi, ai sikurse edhe të tjerët pozoi pyetjen tashmë të ripërsëritur: "A qëndron këtu zj. Bahiga al-Dahabi?" Pasi shushuriti në telefon dhe mori lejen e nevojshme që "bossi" i ndërtimit të ngjitej lart në dhomën



e saj, shpërholi një buzëqeshje të përhumur sarkastike.

Një nga sportelistët u rikthye duke u dridhur nga jashtë, copë-copë nga i ftohti. Errësira, tha i porsa hyri, është mbledhur nga të katër anët e qiellit dhe së shpejti dita do të bëhet natë. Vështrroi jashtë dritares.

Po mendonte rishtas për gruan e dhomës nr. 12. Misterioze. Femër fatale. Filloi të ndiej se si një rrymë paqëndrueshmërie dhe e pavolitshme ishte shpërndarë nëpër hotel qyshkur ajo kishte mbërritur aty. Rrymë që i lejonte ndjesisë së tij të brendshme, nxitje, të ëndrrave të adolehencës, madhështinë molisëse të të qenit i pasur, sundimtar mbi botën.

U trondit nga ëndërimi i obskur kur një zë i papritur pyeti: "A qëndron këtu zj. Bahiga al-Dahabi?" Një njeri trupmadh i mbështjellë me xhybe të kaftanët, çallmë të lidhur mbi krye, dorën e shtrenguar në dorezën ngjyrë gri të ombrellës. "I thoni se Blind Sajed, Pastruesi i Kufomave, ka mbërritur". Gjoksi i bujtinarit brofi nga vendi. Kërcëlliti dhëmbët nga tmerr dhe, duke nëpërdhëmbur, mallkoi burrin dhe gruan bashkë. Por gjithsesi kreu detyrën duke telefonuar. Për të parën herë mori një përgjigje krejt të kundërt nga të gjitha të mëparshmet. "Ju lutem, mund të prisni në sallën e pritjes, zotëri", e urdhëroi sipërmarrësin.

Allah-Allah, për çfarë ka ardhur ky edepsëz këtu? Pse nuk pret përjashta por na sjell tersllëk? Punonte për pesëdhjetë vjet në këtë hotel dhe asnjëherë nuk kishte parë diçka të përngjashme me atë që po ndodhte këtë ditë. Ndiente frikë se shiu do fillonte të zbriste poshtë me rrëke e shkullmë dhe do t'i mbante të ngujuar në hotel, kushedi se për sa kohë të ardhur. Për më tepër që tashmë, midis të tjerëve, ishte edhe sipërmarrësi i Vdekjes!

Myshterinj të rinj mbërritën. Ata erdhën të ndarë, sërë-sërë: pronari i dyqanit të mobilieve të shtrenjta, pronari i super-marketit, pronari i

lëngjeve të frutave, pronari i parfumeve dhe asortimenteve kozmetike, zyrtari i lartë i Thesarit të Shtetit, shefi i redaksisë së gazetës më në zë të vendit, biznesmeni i shitjes së peshkut me shumicë, i autorizuari i firmës për mobilimin e shtëpive, këshilltari i një milioneri arab.

Nëpërmendi se mos dama do ta zhvendoste bashkësinë e krijuar në sallën e pritjes por, çuditërisht, ajo i lejoi të gjithë mysafirët të ngjiteshin lart në dhomë, njërin pas tjetrit. Kamerierët sollën gjithmonë e më tepër gota çaji dhe karrige, ndërsa ai, bujtinari i bujtinës së vogël, mëdshej se ku do të gjente vend për të ulej gjithë ky kallaballëk. A e njohin njëri-tjetrin qysh më parë? Dhe çfarë i ka sjellë të gjithë së bashku? Thërriti sportelistin pranë dhe e pyeti se çfarë dinte më tepër për sa po ngjet. "Nuk e di, nuk di asgjë zotëri", u përgjigj sportelisi. "Duart zgjaten jashtë derës duke marrë karriget dhe çajin dhe firojnë përsëri brenda portës pa na dhënë mundësinë të shohim së ç'bëhet brenda dhomës". Menaxheri mblodhi supet. Për aq kohë sa askush nuk ankohej, i tha vetvetes, nuk kishte pse ndihesh keq.

Blind Sajed, Pastruesi i Kufomave, u avit drejt tij. "Dua t'i kujtoj zonjës se jam duke pritur", tha. "Ajo premtoi se do t'ju thërrasë në kohën e duhur, zotëri", i tha menaxheri me një ndjenjë të dukshme mospërfillje. Por tjetri as që lëvizi nga vendi ndaj u detyrua të telefonoj përsëri duke ngrehur receptorin drejt sipërmarrësit. "Madam, ka kaluar orari i faljes në aksham dhe ju e dini se në dimër dita është e shkurtër", foli qortueshëm Sajed. U përkul mbi telefon, duke dëgjuar një grimë dhe më tej e mbylli aparatit e komunikimit duke u kthyer përsëri në sallën e pritjes.

Nga thellësia e shpirtit bujtinari e nëmi burrin në heshtje. S'kishte dyshim se zonja ishte shkaktarja kryesore që kishte prurë një lugat



të tillë në hotel. I mendonte të gjitha këto, ndërsa shikimin e kishte ngulur në portën e hyrjes plot mllef. Disa zonja zbritën poshtë nga dhoma nr. 12. Frika që e kishte zaptuar u duk se u pakësua kur ato u drejtuan drejt portës së jashtme. "Ja, më në fund disa po ikin dhe të tjerë do të largohen më vonë, gjersa nata të bjerë plotësisht besoj do të jenë bërë firë të gjithë", e justifikoi vetveten. Shqetësohej sepse vetë pozicioni dhe përgjegjësia e tij mund ta shtynin në konfrontim me ata dhe gjindja i përkiste një klase të fuqishme. Shqetësimi dyfishohej me erën që fërshëlente dhunshëm jashtë portës dhe ndjenjën e pikëllueshme që kishte mbuluar rrugët.

Përtej këtyrë pikëllimi të pandalshëm ku zemra e tij hovte prej gjoksi, ai vërejti mu në portën e hotelit, një grup burrash e grash të veshur me mushamatë e shiut. "Për tek madam Bahiga al-Dahabi?" pyeti duke i çuditur të porsaardhurit. Njëri syresh duke qeshur tha: "Po. I thoni zonjës, ju lutem, se delegatët e Organizatës Trashëgimtarët e Rilindjes kanë mbërritur". Kështu që telefonoi dhe pasi ajo e dha pëlqimin e saj, shtoi ngulmueshëm: "Janë dhjetë persona, zonjë e nderuar, dhe salla e pritjes këtu poshtë është në dispozicionin tuaj në rast nevoje". "Nuk është e nevojshme, ka vend të mjaftueshëm në dhomë", kundërshtoi ajo.

Ndërsa delegatët u ngjitën, bujtinari tundi kokën gjithë konfuzion. Herët a vonë do të kemi sherr, mendoi. Si të nxitej prej zallamahisë së kallaballëkut jo të zakonitë në dhomën nr. 12, furia e furtunës ishte gati në shpërthim përjashta. I rikthyer në sallën e pritjes, rroku me një vështrim Blind Sajedin - Pastruesin e Kufomave - duke u zvarritur drejt tij. Goditi me nyjën e gishtit tundueshëm sportelin dhe drejtoi aparatën e telefonit nga tjetri përpara se ky të fliste. Menaxheri dëgjoi ankimet e tij drejt gruas

fatale. Më tej sipërmarrësi shtoi si për justifikim drejt tij: "Të presësh pa bërë asgjë është me të vërtetë e mërzitshme". Menaxheri u tërbua dhe u bë gati ta shante kur dama telefoni në moment, duke kërkuar që ta lidhnin në telefon me gjellëtoren përkarshi. Biseda e saj zgjati disa minuta.

A do të qëndrojnë në dhomë gjer për darkë, peshoi situatën, edhe në qoftë se po, ku do të darkojnë? Sa do të donte t'i hidhte një sy dhomës. Duhet të ishte një skenë jashtë çdo imaginate, një dalli e vërtetë.

Rrëketë vazhdonin përjashta pa asnjë ngutim për t'u ndalur. Një grup profesorësh të Universitetit dhe Klerikë të lartë, hynë duke diskutuar ethshëm, aq sa thjesht nuk bëzajtji, por i lejoj të shkojnë lart. Situata ishte shndërruar në makth kur një i panjohur u fut pa pyetur, pa u ndaluar te sporteli. Bujtinari thirri me zë të lartë për ta ndalur shkelësin e rregullores, por ky edepsëzi u ngjit me vrap pa kthyer xhevap. Atëherë drejtuesi i hotelit urdhëroi muhaxhirët t'i qepeshin pas të paudhit, por këta nuk e arritën sepse me të mbërritur përball dhomës nr. 12, ky u zhduk pas porte si ta kishte përpërë diçka e vrullshme.

U ndie totalisht i vetëm, kishte humbur kontrollin rrënjësor mbi bujtinën e vet. Po bëhej gati të mbliidhte kokë për kokë sportelistë dhe punonjës, kur një burrë u shfaq, ndihma e pae-vitueshme e të cilit ishte e pazëvendësueshme. Shkëmbyen përshëndetje nën shtrëngime duarsh kur i zoti i bujtinës i tha: "Ju keni ardhur tamam në kohën e duhur, i nderuar z. inspektor"

"Tregomë regjistrin", tha oficeri qetësisht.

"Gjëra të çuditshme po ndodhin këtu", llomotiti tjetri.

Ndërsa inspektori, oficer sigurimi, qëmtoi emrat në regjistër, dhe skicoi në bllok, bujtinari ndërhyri përsëri: "Sa po shoh, ju keni ardhur dhe jeni i interesuar për dhomën nr. 12, zotëri? Allah-

Allah, rebelim i madh, hata e vërtetë po ndodh atje".

"Gjithçka që gjendet në natyrë duhet të jetë e natyrshme", tha inspektori i ç'përqendruar, ndërsa duke folur u largua nga sporteli: "Po qe se ndokush më kërkon në telefon, do të jem në dhomën nr. 12".

Sikur i ra damllaja. Një grimë kishte besuar se syri dhe veshi i qeverisë e dinte se ç'po ndodhte në hotel. Rikujtoi se duhej t'i rimblidhte muhaxhirët kur përsëri shikimi i kapi Blind Sajedin që avitej drejt tij. E humbi durimin dhe nervat, duke bërtitur: "Zonja të tha se duhet të presësh gjersa ajo vetë të të ftojë lart!" Tjetri u ngërdhesh qortueshëm nën servilizmin e zakonshëm ndërsa ndërhyri: "Dakord, por po pres që prej një kohe të gjatë..."

"Ju lutem prisni pa bëzajtur. Mos harroni se jeni në hotel dhe jo në bahçen tuaj zotëri!" turfulloi. Tjetri u tërhoq në dukje i qetë, ndërsa bujtinari thirri sportelistin. "Si po vënë gjërat në dhomën nr. 12?"

"Nuk e di, por zallamahi e madhe është duke u bërë".

"Si nuk shtrydhen brenda?! Duhet të jenë në prehrin e njëri-tjetrit tashmë!" tha i matufepsur.

"Aq sa di ti, di dhe unë", u përgjigj sportelisti. "Sidoqoftë oficeri i sigurimit është atje brenda".

Bujtinari shkoi përsëri pranë dritares dhe vërejti se si nata peshonte rëndë-rëndë në boshllëk. Drita po fikej plotësisht jashtë mureve të hotelit, me derdhje rraskapitëse ndriçimi drejt e prej atmosferës së lagësht të bymyer nga era zhurmonjëse që ulërinte përjashta. Një batalion i vërtetë kamerierësh erdhën nga restoranti përkarshi, duke mbajtur takëme të mbushura me të gjitha llojet e gjellëve, dhe mpirja e mendjes së tij u rrit edhe më tepër. Dhoma ka vetëm një të vetme tavolinë buke, ku do t'i shtrojnë gjithë këto pjata? Si do t'i hanë gjithë këto ushqime xhanëm? Njëri nga sportelistët i tha se dyert e dhomës tash nuk mund të hapeshin dot dhe ushqimi po hynte veçse nga dritarja e vogël e ajrimit. Zallamahia dhe sikleti i dhomës po pikëllonte krejt hotelin, e gjithë shfaqja ishte thjesht e pabesueshme.

Pas gjysmë ore, një nga sportelistët konfirmoi se njerëzit që ndodheshin në dhomën nr. 12 ishin bërë hazër në të pirë. "Por nuk vura re asnjë shishe të ngjitet lart!" u shkurtis menaxheri. "Ndoshta i kanë fshehur nëpër xhepa", hamendi sportelisti. "Janë duke kënduar, bërtasin dhe duar-trokasin, burra dhe gra, si haram-sëzër të bërë xurxull".

"Po inspektori?"

"E dëgjova edhe zërin e tij teksa këndonte: O aman, ooo saman aman aman, kjo dynjah është veç duman, duman edhe raki!!!", tha sportelisti.

Bubullimat u ndien përjashta ndërsa bujtinari i tha vetvetes: "Mundet të jem duke ëndërruar, ose thjesht po çmendem".

Në zgripte të mendimeve një grup i porsaardhur u afrua. Nga fytyrat dhe veshjet dukej qashtë se i përkisnin një sërë të ulët

shoqërore, dukeshin fakir-fukarenj. Pyetën nën formulën e njohur të pashmangshme: "A qëndron këtu zj. Bahiga al-Dahabi?" Dëshpërimisht buzëqeshi dhe kontaktoi me telefon gruan fatale. Ajo iu lut t'i mbante të porsaardhurit në sallën e pritjes dhe t'u shërbente për të pirë gjithashtu. Pamja e sallonit tashmë po e pikëllonte edhe më tepër. "Ky hotel nuk është më hotel. Unë nuk jam më pronari i tij. Kjo ditë nuk është më ditë. Lunatizmi po zgërdhiet me ne në trajtat e rakisë, duhmës të cigareve dhe mishit të pjekur!"

Shiu filloi të zbresë litar-litar, i shoqëruar me shkrepitima rrufesh që zbrisnin nga qielli. Kalldrëmi i hyrjes së hotelit po ndriçohej zbehtë veç nëpërmjet llambave të ndezura brenda tij. Sportelisti u qa: "Veç një Zot mund të na shpëtojë!", ndërsa të gjithë të porsaardhurit u strehuan në hajat. Kutitë elektrike majë shtyllave në xhade filluan të shpërthejnë nën trysinë e shiut që njëkohësisht godiste xhamat e dritareve pa pushim. Bujtinari i ngujuar pas shulit të portës kryesore i kishte ngulur sytë drejt e mbi qiellin e errët. Gradualisht poshtë mbi rrugën e përbaltur ishte krijuar një rrymë uji e cila merre me vete rëmbimthi guralecë dhe llucë.

Rrebeshi vinte nga lart duke shkaktuar valë të tërbuara mbi tokën fatkeqe. "Nuk kemi parë hata të tillë, të paktën përgjatë një breznie të tërë", dëshmoi ai. Duke kërkuar pas në të shkuarën e tij, mu përpara syve iu shfaq, një përmytje e tillë nga koha e fëmijërisë. Kujtonte se si atëherë përmytja kishte bllokuar përmytin, fundosur rrugët, shkapërderdhur banesat dhe shkalafitur tavanet. Menjëherë u pozicionua në sportel duke qartësuar të gjitha ndodhitë e mbajtura shënim, pa harruar të japë urdhra dhe orientime për t'i bërë shqisat katër, e sidomos për të mbajtur nën kontroll absolut të gjitha dhomat dhe çatinë.

Në survejim e sipër të krejt situatës pyeti të parin punonjës që iu shfaq atypari: "Më thuaj shpejt të rejtat nga dhoma nr. 12?" "E qeshura dhe kënga nuk ka asnjë shenjë mbarimi, zotëri", tha tjetri duke mbledhur buzët: "Janë azdisur fare, akoma më keq!" Blind Sajedi u largua sallës së pritjes dhe u drejtua drejt derës së jashtme. "Zbythua pas te vendi yt!" iu lëshua me zë të lartë bujtinari. Sipërmarrësi tentoi ta kapte dorezën e derës kur tjetri i turfulloi përsëri akoma më me tërbim: "Nuk do të paralajmëroj më, more vesh. Kthehu pas!"

Rrufetë shpërthenin si bomba dhe shiu përplasej si breshëri mbi parvaze dhe trotuare. I zoti i bujtinës përllorogari të bujtina e tij e vjetër ishte ndërtuar pa betonime të përforcuara dhe nata paralajmëronte për dëme të mëtejshme. Sportelisti i tha: "Kemi ankesa nga dymbëdhjeta për rrjedhje nga tavani dhe uji është duke e përmytur dhomën".

"Dmth., ndaluan nga hajengu?" pyeti i irrituar. "Atëherë yrysh, hajde le ta lëshojnë dhomën!"

"Nuk munden!", kundërshtoi sportelisti.

Por bujtinari vendosmërisht vazhdoi: "Djem, dhomat po përmyten, ndaj mobilizoni krejt personelin të mbyllni vrimat nga ku rrjedh uji dhe t'i përforcojmë pritat me thasë prej rëre!"

"Po dhoma nr. 12 ?" u dëgjuan zërat e punonjësve. "Ata janë ngjeshur brenda saj. Nuk mund të bëjnë xhap përjashta sepse mulla e tyre është fryrë së tepërmi aq sa nuk mund ta hapin derën!"

Tufani ndëshkoi natën përjashta, brenda mpirja totale kishte uzurpuar hotelin, ndërsa punonjësit gulçonin me thasë rëre ndërduar duke u përpjekur ta ndalnin pushtimin e shiut që po depëronte brenda mureve.

Në këtë çast mbi të gjitha ndodhi gjëja më e veçantë: fakirfukarenjtë që ishin duke pritur në sallën e pritjes vrapuan të ndihmojnë në përpjekjen e mundimshme të sapokrijuar.

Bujtinari shikonte i mallëngjyer dhe krenar gjithë këtë skenë në të cilën vetëm Blind Sajed, Pastruesi i Kufomave, nuk mori pjesë.

Pak më vonë sportelisti raportoi përpara tij: "Të varfrit po bëjnë gjithçka është e mundur për ta parandaluar fatkeqësinë" foli ai gjithë krenari. "Por për sa i përket dhomës nr. 12, ata vazhdojnë të jenë në kushte shumë të vështira të cilat po keqësohen gjithmonë e më tepër, imzot". Për sa tha më sipër tjetri, bëri që krejt qenien e bujtinarit ta përshkojë ndjenja e grevistit, njeriut që në shenjë proteste abandonon gjithçka qëllimisht. Nga një njeri i përmbajtur gjer në ato çaste, ai u kthye në një të revoltuar. Neveria që kishte kapluar trupin, mishin, gjakun, nervat dhe shpirtin e tij, më së fundmi dorëzoi edhe rrekat e fundit të urtësisë nënshtruese.

"Dëgjo", bërtiti me zë të lartë: "Dëgjomë më vëmendje se ç'po të them..." Sportelisti zgurdulloi sytë i shokuar, ndërsa i zoti i bujtinës me zërin e ngritur, dha i vetësigurt verdiktin e tij final:

"Harrooje. Harroje dhomën nr. 12 dhe të gjithë dynjanë brenda saj!"

"Imzot, atje burrat po thërrasin dhe gratë po qajnë!" Duke ulëritur si një bishë e plagosur, bujtinari urdhëroi:

"Përqendrohuni mbi çatinë e sallës së pritjes, merrni vesh apo jo. Për sa i përket dhomës nr. 12, harrojeni, lëreni ashtu si është, me gjithçka dhe gjithsecilin që ka brenda!"

Sportelisti thjesht ngurroi për momentin, por zëri shkumëzues i tjetrit në vijueshmëri e shkundi nga vendi: "Vëri vath në vesh të gjitha sa po të them, nguli në tru pa t'u dridhur gjunjët! Kupton?!" Nga dritarja e sallonit bujtinarit të asaj bujtine të vogël iu shpërfaq stuhia që po thyej në zemër të territ, duke shpëlarë kalimthi çdo çast në ikje.

Ndjeu se pesha e barrës po i lehtësohej thellë në shpirt, ndërsa vetëbesimi po i rikthehej së bashku me kthjellësinë e mendjes.

**E rrallë**

## Gjendet varësja e arit katër mijë vjet e vjetër

Billy Vaughan, 54 vjeç, ishte çuditur kur kishte zbuluar një varëse ari 22 karat në një fushë pranë qytetit të vet të lindjes Whitehaven. Varësja i përket epokës së bronzit dhe pesha e saj prej 300 gramësh ar të pastër që vlen mijëra euro. Qaforet prej ari përdorshin si stoli përreth qafës ose kyçit të dorës për të shfaqur pasuri dhe status të lartë në shoqëri.



© Billy Vaughan/BNPS

**FOTO E DITES**




Burra hebrej ultraortodoksë luten përgjatë një muri në qytetin izraelit Ramat Gan, afër Tel Avivit. /AFP/

**E jashtëzakonshme**

## Satelitët filmojnë krijimin e një ishulli

Havaji nuk është i vetmi grup ishujsh që është formuar nga shpërthimet e vullkaneve. Në vitin 2014, një shpërthim masiv formoi ishullin e ri Hunga Tonga-Hunga Hapai. Por ky ishull ka diçka që i ka lënë shkencëtarët pa fjalë. Ky është formimi, evolucioni i një ishulli të ri. Hunga Tonga-Hunga Hapai ishte krijuar në vitin 2014 pas shpërthimit të një vullkani nënujor që çau sipërfaqen. Turistët që ishin aty pranë kishin arritur ta filmojnë shpërthimin. Ishte aq i fuqishëm sa ishin devijuar edhe fluturimet e




avionëve. Kur ishte pastruar tymi, papritur ishte parë një ishull i vogël, rreth 600 km në juglindje të Fixhit, në Paqësor. Ishulli është vetëm 1.5 km i gjatë. Në fakt, shkencëtarët prisnin që të zdukej sërisht brenda pak muajsh nga dallgët. Por tani, pas tre vjetësh, vazhdon të jetë po aty.



**DASHI**  
Kjo ditë do të jetë neutrale dhe me kalimin e orëve, Venusi nuk do të ketë më ndikim negativ.



**DEMI**  
Ju pret një ditë stresuese dhe konfuzë. Gjatë kësaj jave do të keni shumë gjëra për të bërë dhe për të zgjidhur në nivelin ligjor.



**BINJAKËT**  
Gjërat po ndryshojnë gradualisht për më mirë dhe fundi i muajit do të shënojë kthesën e bujshme.



**GAFORRJA**  
Gjatë kësaj dite do të ketë armëpushim, i cili ju përgatit për një periudhë rikuperimi në dashuri. Venusi do të ketë ndikim tranzit në shenjë.



**LUANI**  
Mund të jeni të inatosur me dikë, i cili nuk ka treguar besim tek ju. Do të ndiheni edhe disi të lodhur.



**VIRGJËRËSHA**  
Ju pret një ditë pozitive e cila paralajmëron një javë të mbushur me energji, gjatë së cilës do të keni mundësi të shumta për t'u kapur fluturimthi.



**PESHORJA**  
Jeni përpara një dite të lodhshme dhe stresuese sidomos në punë, pasi mund të jeni duke bërë shumë gjëra njëkohësisht.



**AKREPI**  
Ju pret një ditë nën ritmin e duhur, por që do t'ju bëjë të durueshëm, pasi yjet me kalimin e orëve do të jenë në anën tuaj.



**SHIGJETARI**  
Mundohuni që të jeni më optimist. Edhe nëse gjatë këtyre ditëve nuk po ndodh asgjë e jashtëzakonshme, do të shihni se shumë shpejt diçka shumë e bukur do të vijë.



**BRICJAPI**  
Ju pret një ditë neutrale, e cila paralajmëron një periudhë me angazhime dhe kënaqësi të mëdha. Do t'ju duhet ta kuptoni drejtimin e jetës suaj.



**UJORI**  
Ju pret një ditë e mbushur me nervozizëm për shkak të shumë gjërave që duhet të bëni njëkohësisht.



**PESHQIT**  
Dashuria do të jetë protagonistja e ditës. Do të jeni mjaft të ndjeshëm dhe entuziast.

**BARSOLETA E DITËS**



**Mësuesja:** Pse u vonove sot në orën e parë?  
**Nxënësi:** I kishte humbur 100 euro një burrë.  
**Mësuesja:** Me siguri ti e ndihmove që t'i gjejë?  
**Nxënësi:** Jo mësuese, por i kisha fshehur paratë nën këmbë derisa u largua burri!



**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

**Çdo ditë në ora 16:00**  
**Toy Story 4 / 3D**

I Animuar/Aventurë/Komedi;  
1 orë 40 min

**Rolet:** Tom Hanks (Woody), Annie Potts (Bo Peep), Tim Allen (Buzz Lightyear), Tony Hale (Forky), Keegan-Michael Key (Ducky), Madeleine McGraw (Bonnie), Christina Hendricks (Gabby Gabby), Don Rickles (Mr. Potato Head), Jordan Peele (Bunny), Wallace Shawn (Rex), John Ratzenberger (Hamm), Keanu Reeves (Duke Caboom), etj.

**Regjia:** Josh Cooley




**Në ora 18:00 dhe 20:00**

**AD ASTRA**

Aventurë/Dramë/Mister; 2 orë 04 min

**Rolet:** Brad Pitt, Tommy Lee Jones, Ruth Negga, Liv Tyler, and Donald Sutherland

**Regjia:** James Gray



**Çdo ditë në ora 22:00**

**DOWNTON ABBEY**

Dramë; 2 orë 02 min

**Rolet:** Hugh Bonneville, Jim Carter, Michelle Dockery, Elizabeth McGovern, Maggie Smith, Imelda Staunton, Penelope Wilton, etj.

**Regjia:** Michael Engler

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



## Victoria Beckham nuk ka frikë të plaket



**V**ictoria Beckham është një nga ikonat e modës për dekada, por stilistja dhe këngëtarja e famshme ka zbuluar se nuk frikësohet nga plakja. Victoria është shprehur se ndihet mirë me moshën që ka. 45-vjeçarja ka thënë se dëshiron të duket mirë për moshën që ka dhe se nuk përpiqet të duket më e re. Në një intervistë për "This Morning" nëna e

katër fëmijëve ka thënë se është në rregull me faktin që po plaket. "Nuk mundohem të dukem më e re. Thjesht dua të dukem mirë për moshën që kam. Dua të dukem versioni më i mirë i vetes sime. Dua të kujdesem për ato që kam dhe të mos ndryshoj asgjë. Më pëlqen se si ndihesh kur vitet kalojnë. Të gjithë do të plaken, por nuk më pëlqen se si tingëllon fjala 'plakje'", ka thënë ajo.

## Arta Nitaj lajmërohet nga Dubai



**A**ktorja dhe fotomodeluesja ka udhëtuar drejt Dubait bashkë me shoqe. Arta Nitaj ka shkuar në këto pushime për t'i filluar festimet e ditëlindjes të cilën e ka në plan ta festojë gjatë gjithë javës. Ajo tashmë ka filluar të postojë në llogarinë e vet në "Instagram" nga vendi luksoz ku po qëndrojnë, e sigurisht se fotografitë në bikini nuk mungojnë. Ajo ka treguar se ka përzgjedhur Dubain për

t'i kaluar këto pushime përmes storieve të postuara në "Instagram". Madje Arta e ka postuar thujse gjithë udhëtimin që nga fotoja me pasaporta në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës. Arta ka udhëtuar pasi ka përfunduar procesi i zgjedhjeve në Kosovë, në të cilat edhe ajo ishte e përfshirë në këto zgjedhje. Ajo është anëtarësuar në Partinë Demokratike të Kosovës.



## Morena Taraku Pozon nudo

**K**ëngëtarja Morena Taraku, e cila po përflitet vazhdimisht për operacione plastike, së fundmi ka pozuar nudo. Ajo ka pozuar nudo dhe këtë fotografi e ka shkrepur fotografi Norik Uka.

Ajo ka ndryshuar në mënyrë drastike nga operacionet plastike dhe dita-ditës po i ngjan më shumë Angelina Joliet. Ndryshe, Morena ka paralajmëruar edhe një këngë të re, por që kjo ende nuk doli.

## Kim Kardashian pagëzon fëmijët në Armeni



**Y**lli amerikan i reality shout, Kim Kardashian, ka pagëzuar fëmijët e vet gjatë një vizite në vendin e origjinës së vet, Armeni. Kardashian kishte veshur një fustan të ngushtë bezhë dhe është ndalur për të bërë foto me fansat lokalë. Pagëzimi është mbajtur në Holy Echmiadzin, katedralja më e madhe e vendit kaukaz. Kourtney Kardashian ka qenë në krah të saj, ndërkohë që

ka munguar reperi Kanye West. Vizita është e para në vend që nga viti 2015. Paraardhësit armenianë të Kardashianit, nga ana e të atit, kishin emigruar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vetë Kimi nuk humbet rastin ta përmendë apo vizitojë vendin e origjinës. Armenia ka qenë vendi i parë në botë që ka pranuar krishterimin si një besim zyrtar fetar në shekullin e katërt.

# Hapat e Rëndësishëm për të dalluar mjaltin e vërtetë

Mjalti, ai i miri, organik dhe natyrali është një produkt i kërkuar dhe i çmuar për të gjithë shqiptarët.

Ky nektar i ëmbël shpesh është cilësuar si "ari i lëngshëm" dhe si rrjedhojë çmimet e tij mund të jenë të shtrenjta.

Megjithatë, ndodh shpesh që çmimi i mjaltit në treg nuk reflekton cilësinë e mjaltit që njerëzit blejnë dhe konsumojnë.

Një pjesë e mirë e mjaltit që shitet në mbarë vendin është i rremë.

Nuk është as i vërtetë as organik, përkundrazi përmban gjithëloj aditivësh, që do të thotë se njerëzit bien pre e mashtrimit.

**Më poshtë do të gjeni këshillat e AgroWeb që do e bëjnë më të lehtë dallimin e mjaltit cilësor nga ai falso.**

1. Mjalti i vërtetë ka grimëza të vogla brenda tij, që janë pjesë e polenit, hojeve ose bletëve dhe që janë të ngrënshme. Mjalti i rremë është tepër i kulluar për të qenë i vërtetë.

2. Mjalti i vërtetë është i dendur dhe i trashë, ndërsa ai i rremi është i hollë.



4. Mjalti i vërtetë nuk ngjit si zamkë kur e fërkon mes gishtave. Ai i rremi nga ana tjetër është plot me ëmbëlsues të rremë që e bëjnë të ngjitshëm.

5. Shija e mjaltit të vërtetë është e lehtë dhe shuhet pas disa minutash. Shija e mjaltit të rremë është shumë e ëmbël dhe zgjat për shumë kohë.

6. Mjalti i vërtetë nuk formon bulëza kur ngrohet, por karamelizohet. Mjalti i rremë formon bulëza dhe nuk karamelizohet kurrë.

7. Mundohuni të blini mjaltë direkt nga një bletë-rritës i besueshëm. Tek ata keni mundësinë ta provoni mjaltin dhe të merrni përgjigje të sakta për çdo pyetje në lidhje me mjaltin në shitje.

8. Kujdes me etiketën. Mjalti i vërtetë duhet të përmbajë vetëm një përbërës – mjaltë! Disa prodhues ose kompani shtojnë përbërës të tjerë në listë, shije, ëmbëlsues, aditivë, dhe elementë artificialë.

Ai nuk është mjaltë i vërtetë. Disa prej aditivëve të shtuar përfshijnë: shurup misri, niseshte, glukozë ose shurup sheqeri.

Produktet që mbajnë emërtime jo fort të qarta në etiketë janë qartësisht shumë larg mjaltit.

Legjislacioni në fuqi, jo domosdoshmërisht detyron shitësit e mjaltit të theksojnë nëse kanë shtuar aditivë tek mjalti, dhe fakti që në një etiketë ju nuk gjeni të shkruar informacione të metejshme, nuk do të thotë që po

blini mjaltë të vërtetë.

**Disa mënyra se si mund të përcaktoni vërtetësinë dhe origjinalitetin e mjaltit**

Hidhni pak mjaltë në një fetë bukë. Nëse mjalti është i rremë, buka do të laget për shkak të lagështisë në lëng.

Nëse mjalti është i vërtetë, buka nuk qulloset, përkundrazi bëhet e fortë për pak minuta.

Hidhni mjaltë në një gotë me ujë. Mjalti i rremë shkrihet shpejt, ndërsa ai origjinali jo. Mjalti origjinal rri i mbledhur dhe zhytet në fund të gotës.

Na tregoni më shumë për metodat tuaja të veçanta se si arrini të dalloni mjaltin e vërtetë nga ai i rremi./AgroWeb.org

Ata paguajnë një sasi të madhe lekësh duke menduar se po blejnë mjaltë cilësor.

Problemi me mjaltin e falsifikuar – origjina e së cilit është e panjohur, është gjithëpërfshirës. Në formën e tij origjinale, mjalti përmban polen, dyllë bletësh dhe disa produkte të tjera.

Çdo lloj poleni është i veçantë në aspektin gjeografik dhe tregon qartazi rrugëtimin e bletës dhe lulet e preferuara të saj.

Kur mjalti përpunohet, prodhuesit e nënshtrojnë mjaltin në një proces filtrimi të hollë që heq të gjitha 'papastërtitë'.

Ky proces e bën mjaltin të pagjurmueshëm dhe jo të pastër në aspektin e cilësisë.

Në shumicën e rasteve të mjaltit të importuar, prodhuesit përdorin edhe shije artificiale dhe përbërës të tjerë që largojnë të gjithë elementët unikë të mjaltit. Duke e bërë atë të "padukshëm", prodhuesit ia heqin të gjitha vlerat shëndetësore mjaltit. Janë pikërisht ato 'papastërti' që e bëjnë mjaltin plot vlera për njeriun.

Konsumatorët nuk janë plotësisht të informuar për nivelin alarmant të mjaltit jo cilësor që shitet në treg. Si mundet të dallojë konsumatorit mjaltin e vërtetë nga ai i manipuluar?



# Mënyrat natyrale për të lehtësuar dhe kuruar ulçerën e stomakut

Ulçera shfaqet në shtresën e brendshme të stomakut. Ajo ndodh kur acidi i stomakut irriton shtresën e lartpërmendur. Shkaktarët e ulçerës janë infeksioni bakterial por edhe përdorimi afatgjatë i medikamenteve si ibuprofeni apo aspirina. Ushqimet pikante nuk shkaktojnë ulçerë por e përkeqësojnë, atë sepe rrisin prodhimin e acidit.

## MËNYRAT PËR TË LARGUAR DHIMBJEN E ULÇERËS NË STOMAK.

### Probiotikët

Probiotikët janë organizma të gjallë që rikthejnë ekuilibrat e bakteve në aparatit tretës. Ato ulin nivelin e bakteve të këqija që shkaktojnë ulçerë, përshpejtojnë shërimin dhe përmirësojnë disa prej simptomave. Probiotikët gjenden tek kosi, ushqimet e fermentuara dhe suplementët.

### Xhenxhefli

Xhenxhefli përdoret gjërësisht

kundër problemeve me tretjen siç është konstipacioni, fryrjet, gastriti etj.

Sipas disa studimeve, konsumi i xhenxheflit ndihmon në kurimin e ulçerës gastrite dhe asaj të shkaktuar nga medikamentet.

### Frutat shumëngjyrëshe

Frutat plot ngjyra përmbajnë flavonoidë të cilët ndihmojnë kundër ulçerës në stomak por edhe problemeve të tjera me tretjen.

Flavonoidët gjenden tek mollët, boronicat, qershitë, agrumet dhe arrorët.

### Mjalti

Mjalti lufton mikrobet dhe bakteret, ndaj është i dobishëm kundër ulçerës në stomak.

Njerëzit e përdorin mjaltin për të përshpejtuar shërimin e lëndimeve në lëkurë, të djegurave dhe plagëve.

### Hudhra

Hudhra është efikase kundër ulçerës.

Ajo e parandalon zhvillimin e saj



dhe përshpejton shërimin.

Sipas disa studimeve, ngrënia e dy thelpinjve hudhër gjatë dy vakteve në ditë shkatërron bakteret përgjegjëse për ulçerën.

Hudhrën mund ta përzeni me

mjaltë për më shumë shije dhe vlera.

### Kamomili

Çaji i kamomilit përdoret kundër ankthit, kontraktimeve të zor-

rëve dhe inflamacionit. Disa studime thonë se ekstraktet e kamomilit pengojnë zhvillimin e ulçerës dhe përshpejtojnë shërimin.

*AgroWeb.org*

## Treguesit paralajmërues të një ataku në zemër


Në Shqipëri, 9000 njerëz vdesin çdo vit për shkak të sëmundjeve të zemrës. Ataku në zemër është një nga sëmundjet më të përhapura të zemrës në vendin tonë. Sëmundjet kardiovaskulare janë shkaktare të shumë vdekjeve në botë. Sëmundjet kardiovaskulare përfshijnë edhe difektet e zemrës, aritminë dhe sëmundjen e arterieve koronare. Shëndeti i zemrës përmirësohet nëse ushqeheni mirë, konsumoni suplementë si Omega 3 ose hekuri si dhe kryeni aktivitet fizike. Megjithatë, ju duhet t'i vini veshin trupit tuaj që është në gjëndje të japë paralajmërimet e një ataku në zemër.

Një atak në zemër ndodh kur gjaku i pasur me oksigjen që rrjedh në vena krejt papritur has një pengesë dhe nuk mund të arrijë në muskulin e zemrës. Si pasojë, kjo pjesë e zemrës nis e vdes për shkak të mungesës së oksigjenit.

E gjithë zemra mund të shuhet nëse nuk ushqehet me gjak. Nëse kundërveprimi është i ngadaltë, atëherë zemra resht së rrahuri dhe njeriu vdes.

### Shenjat e atakut në zemër

Lodhja e tepërt është një prej shenjave të para të një ataku në zemër. Është mëse normale të ndiheni të lodhur pas një dite stresuese, por



nëse lodhja është kronike atëherë duhet të shqetësoheni dhe të kryeni analizat.

Nuk është natyrale të ndiheni të lodhur pasi keni fjetur mirë, ngrënë mirë dhe nuk keni bërë asgjë gjithë ditën. Çrregullimet e gjumit janë një tjetër tregues paralajmërues i atakut në zemër.

Në këtë mënyrë, subkoshienca po ju tregon se ka diçka që nuk shkon.

Çrregullimet e gjumit mund të jenë pasojat e nevojës për të urinuar më shpesh, etjes së madhe dhe nevojës për ujë. Konsultohuni me një mjek dhe sigurohuni që gjithçka është në rregull.

Një tjetër shenjë paralajmëruese është mungesa e frymëmarrjes. Nëse zemra nuk furnizohet mjaftueshëm me oksigjen, atëherë do ju duket sikur ju mungon ajri.


Tretja e keqe është një tjetër shenjë paralajmëruese e atakut në zemër. Nëse stomaku është gjithnjë i trazuar, atëherë diçka nuk shkon. Kini parasysh që tretja problematike mund të shkaktohet edhe nga ushqimet pikante.

Nëse ndjeni dobësi në pjesën e krahëve, dhe ankth në rritje, atëherë edhe kjo mund të jetë tregues i një ataku në zemër për shkak të

mungesës së oksigjenit. Kur kjo ndodh zemra i dërgon një sinjal shpinës.

Të gjithë nervat shpërndahen në krahë dhe shkaktojnë ndjesinë e dhimbjes. Nëse ndieni mpietje tek duart, atëherë një atak në zemër mund të ndodhë nga momenti në moment. Nëse kuptoni që keni këto simptoma, vizitohuni tek një mjek menjëherë.

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

# Fiton Gjilani, çalon Drita

Gjilani ka marrë tri pikë të martën ndaj Dukagjinit dhe i është afruar liderit të elitës, Ballkanit, në dy pikë. Ndërsa skuadra e Dritës ka çaluar ndaj Drenicës dhe ka humbur mundësinë të ketë pikë të barabarta me skuadrën nga Suhareka



**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 8 TETOR** - Rangu elitar i Kosovës në futboll sa vjen e bëhet më interesant dhe ndryshimet në renditjen tabelore thajse po ndodhin çdo javë. Të martën përfundoi java e nëntë, kurse fitores iu gëzua Gjilani që e mposhti skuadrën e Dukagjinit të Klinës (1-0) dhe në këtë mënyrë ngritët në pozitën e tretë me dy pikë më pak se Ballkani që e kryeson renditjen tabelore.

Vendësit kaluan në epërsi në minutat shtesë të pjesë së parë, derisa golashënues ishte Tomislav Busiq. Në pjesën e dytë rastet nuk munguan, por nuk pati ndryshim rezultati dhe ndeshja përfundoi 1-0. Pas kësaj humbje, Dukagjini e thallon krizën ku nga nëntë ndeshjet e zhvilluara në Superligë ka grumbulluar vetëm katër pikë. Në ndeshjen tjetër të zhvilluar në stadiu-

min "Bajram Aliu" në Skenderaj mes Drenicës dhe Dritës nuk pati fitues, pasi ndeshja përfundoi 1-1.

Ish-kampionia e Kosovës në futboll, Drita, kaloi e para në epërsi në minutën e 39. Sulmuesi Gilberto Fortunato realizoi për 0-1. Megjithatë, skuadra kuqezi nuk u ndal për asnjë çast dhe arriti të barazojë rezultatin dy minuta pa përfunduar koha e rregullt e ndeshjes, kurse autor i golit ishte Diar Prokshi. Pas kësaj ndeshje Drita mbetet e dyta me 18 pikë, kurse Drenica renditet në vendin e tetë me 9 pikë. "Për ta fituar ndeshjen duhet të japim më shumë, pasi rezultatin e kishim në favor tonin e në anën tjetër humbëm disa raste. Drenica kërkoi golin e barazimit dhe në fund arriti të shpërblehet. Pikët që lamë janë të rëndësishme, por ka shumë lojë. Tashmë e presim Ballkanin dhe do përpiqemi t'i marrim pikët maksimale", ka thënë Ardian Nuhiu, trajner i Dritës.

**IPKO SUPERLIGA**

Gjilani - Dukagjini	1-0
Drenica - Drita	1-1
Ballkani - Prishtina	1-0
Trepça '89 - Feronikeli	1-1
Vushtrria - Ferizaj	2-2
Llapi - Ferizaj	2-4

**TABELA**

1. Ballkani	9	20 pikë
2. Drita	9	18
3. Gjilani	9	18
4. Llapi	9	17
5. Feronikeli	9	16
6. Prishtina	8	13
7. Trepça '89	9	10
8. Drenica	8	9
9. Ferizaj	9	9
10. Flamurtari	9	8
11. Vushtrria	9	6
12. Dukagjini	9	4

**LIGA E PARË**

Onix - 2 Korriku	2-0
Arbëria - Vitia	0-0
Liria - Dardana	1-0
Drenasi - Ramiz Sadiku	1-0
Trepça - Malisheva	1-0
Istogu - KEK-u	1-1
Ulpiana - Besa	0-2
Vëllaznimi - Vllaznia (P)	1-4

**TABELA**

1. Liria	8	19 pikë
2. Istogu	8	17
3. Malisheva	8	16
4. Besa	8	14
5. Trepça	8	14
6. Arbëria	8	14
7. Dardana	8	14
8. Drenasi	8	12
9. Onix	8	10
10. Vllaznia	8	9
11. Ulpiana	8	8
12. Ramiz Sadiku	8	7
13. 2 Korriku	8	7
14. KEK-u	8	6
15. Vitia	8	6
16. Vëllaznimi	8	4

**SHKURT**

**Celina mezi e pret ndeshjen ndaj Malit të Zi**

Bersant Celina mezi po e pret ndeshjen me Malin e Zi të cilën Kosova do ta zhvillojë më 14 tetor në kuadër të kualifikimeve për "Euro 2020". "I rikthehem ekipit kombëtar. Do ta zhvillojmë një ndeshje mjaft të rëndësishme kundër Malit të Zi. Le t'ia dalim. Ndër të tjera, shikoni tifozët tanë", ka shkruar Celina në "Instagram".

**Berisha për Gjermaninë refuzon Kosovën dhe Shqipërinë**

Sulmuesi me origjinë shqiptare, Mërgim Berisha, ka refuzuar Shqipërinë dhe Kosovën. 21-vjeçari ka pranuar zyrtarisht ftesën e Gjermanisë U-21 për dy ndeshjet e këtij muaji ndaj Spanjës dhe Bosnjë Hercegovinës. Por, Berisha ka ende kohë që të ndërrojë mendje dhe të mos luajë në skuadrën e parë të Gjermanisë, në mënyrë që t'i lejohet kalimi te Kosova. Aktualisht sulmuesi shqiptar luan te Rheindorf Altach, kurse është në huazim nga Red Bull Salzburgu i Austrisë.

**Pensionohet Schweinsteigeri**

Bastian Schweinsteiger edhe zyrtarisht është pensionuar nga futbollit aktiv. Mesfushori 35-vjeçar që është aktualisht pjesë e Chicago Fire do t'i varë këpucët në gozhdë në fund të sezonit aktual në MLS. Schweinsteigeri regjistroi 500 paraqitje për Bayern Munichun, duke e fituar tetë herë titullin në Bundesligë dhe një herë Ligën e Kampionëve. Ai e fitoi edhe Kupën e Botës më 2014 me Gjermaninë, për të cilën i ka bërë 121 paraqitje gjatë karrierës. "Të dashur tifozë, ka ardhur koha që unë t'i jap fund karrierës sime aktive në fund të këtij sezoni. Dua t'ju falënderoj juve dhe ekipet e mia, Bayern Munchen, Manchester United, Chicago Fire dhe ekipin kombëtar gjerman. Ju e bëtë të mundur këtë kohë të jashtëzakonshme për mua", ka thënë Schweinsteigeri.

## Eroll Salihu: Ndeshjet ilegale të Serbisë nuk do të zhvillohen në Kosovë

**PRISHTINË, 8 TETOR** - Mediat serbe raportojnë se të mërkurën do të zhvillohet ndeshja në kuadër të Kupës së Serbisë ndërmjet Cërvena Zvezdes së Beogradit dhe ekipit serb Trepça në Kosovë, ani pse ende nuk kanë marrë leje nga Federata e Futbollit e Kosovës (FFK). Lojtarët e skuadrës së Cërvena

Zvezdës sot (e mërkurë) në orën 11 pritet të jenë në pikën kufitare në Jarinë. Mirëpo një gjë të tillë nuk pritet ta lejojë Federata e Futbollit e Kosovës e që, sipas sekretarit të përgjithshëm, Eroll Salihu, një gjë e tillë është absurde dhe tanimë FFK-ja ka njoftuar organet përgjegjëse që ta ndalojnë zhvillimin e kësaj

ndeshje. "E kemi lajmëruar policinë, UEFA-n dhe FIFA-n. Kjo ndeshje është ilegale dhe nuk do të lejohet të luhet. Tanimë organet shtetërore duhet ta bëjnë punën e tyre, të mos lejojnë hyrjen e ekipit serb në Kosovë. Kosova kurrë nuk ka qenë pjesë e Federatës Serbe e tash në këtë kohë ata po tentojnë

të hyjnë në Kosovë për të zhvilluar një ndeshje ilegale. Kjo është absurde. Shpresojmë që organet kompetente të mos lejojnë që një ndeshje e tillë të zhvillohet në territorin e Kosovës", ka thënë Salihu për "KosovaPress". Ndeshja mes këtyre dy klubeve është paraparë të zhvillohet nesër me fillim nga ora 15:00.



## Rossi: Marquezi shumë shpejt do t'i thyejë rekordet e mia

ROMË, 8 TETOR - Marc Marquez fitoi të dielën titullin e tetë kampion në karrierën e vet, të gjashtin në Moto GP, duke qenë një titull afër legjendës Valentino

Rossi. Piloti italian shprehet se tashmë rekordi i tij do të thyhet shumë shpejt. "Marquezi dominoi në këtë sezon, duke u renditur gjithnjë në dy vendet e para.

Po garon ashtu sikurse bëja unë kur isha në formën më të mirë", ka thënë Rossi. I pyetur rreth faktit se shumë shpejt rekordi i tij mund të bjerë, Rossi ka deklaruar:

"Po, kjo është e mundur të ndodhë në të ardhmen. Nuk ka për të vuajtur shumë për të më arritur. Më vjen keq pasi 1 apo 2 tituj kampion i kam humbur vetë".



## Peja e Feronikeli në 'Karagaçi' ndajnë 'mejdantin'

PRISHTINË, 8 TETOR - Në këtë mesjavë do të zhvillohen tri ndeshje në kuadër të javës së katërt të Superligës së Kosovës në basketboll, derisa ndeshja Trepça - Rahoveci zhvillohet më vonë për shkak se "Vreshtarët" do të luajnë në kualifikimet e FIBA Europe Cup. Sigal Prishtina pushon në këtë xhiro. Ndeshja e parë është ndërmjet Feronikelit dhe Pejës, e cila do të zhvillohet në



'Karagaçi'. Feronikeli këtë edicion ka hyrë në Superligë dhe në dy ndeshje, ka dy humbje, kurse Peja e rikthyer në elitë ka një fitore dhe një humbje. Lipjani që ka tri humbje në tri ndeshje takohet me Ponte Prizrenin, takim që zhvillohet të mërkurën nga ora 19:00.

Ndërkohë, ndeshje shumë interesante pritet të enjten në mes të Bashkimit dhe Golden Eagle Yllit. Prizrenasit kanë dy fitore në dy ndeshje, kurse Ylli tri fitore në tri ndeshje dhe njëra skuadër do të 'njoftohet' me humbjen e parë në këtë edicion.

### SUPERLIGA - Java 4

Të mërkurën takohen:  
16:00 Feronikeli - Peja  
19:00 Lipjani Ponte Prizreni

Të enjten takohen:  
19:00 Bashkimi - Golden Eagle Ylli  
Trepça - Rahoveci (zhvillohet në një termin tjetër)  
Sigal Prishtina (pushon)

## Gjimshiti dhe Seferi, optimistë për ndeshjen kundër Turqisë



DURRËS, 8 TETOR - Kombëtarja e Shqipërisë është në prag të mbylljes së grumbullimit në Durrës pasi ditën e mërkurë në mëngjes do të nisët drejt Stambollit ku më 11 tetor do të luajë përballë Turqisë. Në konferencën e fundit për shtyp nga Shqipëria, Berat Gjimshiti ka theksuar edhe një herë vështirësinë dhe rëndësinë e dy ndeshjeve të radhës me Turqinë dhe Moldavinë. "Na presin 2 ndeshje shumë të vështira, sidomos ajo me Turqinë, por besoj se kemi shanse të vërteta sepse në ndeshjen e parë bëmë gabime

individuale me këtë skuadër. Besoj se ajo ishte ndeshje e mirë dhe ne kishim rastet tona. Këtë ndeshje duhet ta shohim si një shans të ri. Do të shkojmë atje dhe do ta japim maksimumin. Për Elseid Hysajin më vjen keq që u dëmtua para ndeshjes me kombëtaren. Është një lojtar me përvojë, por besoj se nuk do të na mungojë", është shprehur Gjimshiti.

Veç mbrojtësit të Atalantës dhe të kombëtares kuqezi, në konferencë për shtyp ishte edhe sulmuesi nga Kumanova, Taulant Seferi, i marrë nga ekipi shpresa.

"Jam i befasuar e i kënaqur, djemtë më kanë prit mirë, shoh pozitivitet në kombëtare dhe shpresoj ta përcjellim në sfidat e ardhshme. E kam pritur ftesën, jam mirë dhe shpresoj ta jap maksimumin", ka thënë Seferi. Një ditë përpara nisjes për në Turqi trajneri Edi Reja ka bërë një tjetër ndryshim në listën e të grumbulluarve për këto dy ndeshje. Ekipit i është bashkuar tashmë edhe Hysen Memolla, një lëvizje kjo e kushtëzuar për trajnerin italian pas dëmtimit të Elseid Hysajit në prag të grumbullimit.

### SHKURT

#### Gjoka, trajner i Shkëndijës së Tetovës

Ernest Gjoka do të jetë trajneri i ri i Shkëndijës së Tetovës. Ka qenë vetë klubi kuqezi që nëpërmjet një postimi në faqen zyrtare ka prezantuar teknikun nga Tirana si timonierin e ri të skuadrës. Gjoka ka firmosur kontratë me kampionët në fuqi të Maqedonisë. 49-vjeçari do ta zëvendësojë Qatim Osmanin e larguar disa javë më parë, teksa postin e trajnerit kohët e fundit e mbante provizorisht Erhan Selimini. Kujtojmë se Gjoka është trajneri i dytë nga kryeqyteti i Shqipërisë që do ta drejtojë Shkëndijën në vitet e fundit, pasi skuadra tetovare është drejtuar edhe nga Shpëtim Duro gjatë sezonit 2015-2016.

#### Bale vendos të largohet nga Reali

Gareth Bale dëshiron të largohet nga Real Madridi. Futbollisti uellsian ka vendosur se karriera e tij duhet të vazhdojë diku tjetër duke nisur nga janari, ose në fund të këtij sezoni. Ai e kishte kuptuar prej kohësh që kishte zbritur ndjeshëm në piramidën e hierarkisë së skuadrës, ndërsa është bindur përfundimisht pasi Zinedine Zidane vendosi ta lë në tribunë për ndeshjen e fundit në Ligën e Kampionëve kundër Club Brugge. Lajmi bëhet me dije nga e përditshmja "Marca". Futbollisti nuk ndihet i vlerësuar, madje shprehet se po trajtohet shumë keq nga Zidane. Për këtë arsye, raporti mes lojtarit dhe teknikut është ngrirë prej kohësh aq sa, sipas gazetës "Marca", nuk ka më komunikim.

#### Van Dijk: Herët të flasim për titull

Liverpooli ka tetë pikë më shumë se Manchester City, pasi kampionët në fuqi të Anglisë dështuan në ndeshjen ndaj Wolves (0-2). Pavarësisht prej kësaj epërsie, Virgil van Dijk s'dëshiron të flasë për titull, duke insistuar se "gjithçka mund të ndodhë". "Deri më tani kemi marrë shumë pikë. Ka gjithmonë hapësirë për t'u përmirësuar në lojën tonë. Ne duhet të fokusohemi në ndeshjet që kemi para dhe mos të shikojmë diferencën me pikë me të tjerët, përfshirë Cityn. Do të ketë kohë të vështirë që po vijnë, shembull dhjetori dhe janari (janë dy muaj me shumë ndeshje) dhe mendoj se gjithçka do të ndodhë", ka thënë Van Dijk.

Van Dijk foli edhe për humbjen e befasishme të Man Cityt në shtëpi. "Nuk e prisja, natyrisht. Mendoj se të gjithë prisnin ndeshje të vështirë për Cityn, por kur City luan në shtëpi nuk ndodh pothuajse kurrë që të mos shënojë të paktën një gol. Ishte paraqitje fantastike nga Wolvesi dhe duhet ta përgëzoj atë. Por, ai (City) do të tentojë të kthehet. Deri atëherë unë duhet të fokusohem te futbollit me kombëtaren", ka deklaruar Van Dijk.

#### Dybala: Asnjëherë nuk mendova të largohem nga Juve

Paulo Dybala ka riafirmuar angazhimin ndaj Juventusit pas një vere në të cilën ishte i lidhur me largimin nga Torino. Manchester Unitedi edhe Tottenham ish in në garë për yllin argjentinas të cilin Juve dëshiron ta shiste në verë. Dybala është ri-integruar përsëri në skuadrën e Maurizio Sarri dhe e ka ndihmuar Juven që ta fillojë një sezon të fortë. Kampionët italianë janë në krye të Serisë A dhe të pamposhtur në të gjitha garat. "Unë nuk kam pasur një verë të lehtë. Pa dyshim se ta dëgjosh emrin tënd të lidhur me çdo ekip ku nuk dëshiron të shkosh nuk është gjë e bukur, por ky është futbollit. Para se të fillonte merkatoja unë kisha bërë tashmë një intervistë në të cilën thashë se doja të qëndroja në Torino. Atëherë nuk fola kurrë më, madje as në Copa America", ka thënë Dybala. "Unë mendoj se është më e rëndësishme të flasim në terren, me fakte. Asnjëherë nuk e dini se si shkon merkato deri në ditën e fundit, por kam dashur të qëndroj këtu, kam dashur ta vazhdoj karrierën te Juventusit. Mendoj se ende mund t'i jap kaq shumë fanellës dhe jam shumë i lumtur me atë që tregova kundër Interit", ka deklaruar Dybala.



EPOKA ERE		Autor: GAZMEND MORINA	KËNGËTARJA KANADEZE NË FOTO (shqip.)	TREGIMTAR, QË INFORMON, QË KALLËZON	DËSHIRË QË LË NJERIU ME FJALËT E FUNDIT PARA VDEKJES	MUAJ I VITIT	OHIO, LOUISIANA	REPART I SPITALIT KU LINDIN FOSHNJAT	ZANORE	NJË E PANJOHUR NË MATEMATIKË (shq.)	TRAJNERI KROAT ... BARIÇ	SHOK	EPOKA ERE
													QYTET SHQIPTAR NË MAL TË ZI
										SHTET (huaj) UGANDA, LIBERIA			
								KUJDESTARI (jur.) PJESE E VITIT (shq.)					
											ANA VISI SHKRONJA TË NJËJTA		
									PËRSËRITËS (gram.)	TENISTJA KURNIKOVA SPIUNIA MË E NJOHUR E TË GJITHA KOHËRAVE			
								SHPIRTI (Lat.) NJËZËSH-MËRI				BASHKËT. SHTERPËSI	
								VADITA TOKË E PUNUAR, POR E PAMBJELLË			PO (IT.) KITARISTI I SHQUAR KLEPTON		
EPOKA ERE	PORTOFOLI	SHTET NË AMERIKËN	KLUB FUTBOLLI ARGJENTINAS "... LORENZO"	↓	AJO QË BESON NË SHUMË HYJNI (pashq.) RRALLË (Lat.)	OSAKA	BASHKIM I FORTË (sh.shq.) ZANORE						AKTORI FLLOKO
						SHIU I I IMËT BASHKËT.				ARKAT SHTETËRORE (lat.)			
							ALEN NURI VINÇ			KËNGËTARJA ADELINA VLERË, DOBI (krah.)			
						QË PRODHOHET NË SERI BASHKËT.				NDESHJE BASHKËT.			
			BASHKËT. PAVLEFSH-MËRI, PAVLERËSI (jur.)		MES I TRUPIT SËPATË E VOGËL (sh.shq.)			EMËR I LASHTË PËR EGJIPTIN CEREMONITË FETARE			"LOKEREN" SHARRËZ		
						TRAJNERI TURK FATIH ..... JOD				QYTET NË KOSOVË (pashq.) BASHKËT.			E PANDERSHME
				ADEM JASHARI ERMELINDA MEKSI			KOHË, MOT (sh.shq.) DISIPLINË SPORTIVE			GAFORRE	SHKRONJË GREKE FUTBOLLISTI NIGERIAN MIKEL JOHN (CHELSEA)		
EPOKA ERE	SËMUNDJE E TOKËS KRYEQYTETI I LIBISË				SECILA NGA DY BRINJËT E NJË TREKËNDËSHI KLUB FUTBOLLI NË SPANJË				DREMIT NDENJUR SQUARE ARRAY KILOMETRE				
		TERRITOR I IMAMIT (sh.shq.) PUNIM I ARËS							MODELI DHE AKTORI AMERIKAN ANTONIO PJESETAR I NJË FISILIR				
	REMOTE ACCESS TECHNOLOGY			LLOJ LETRASH FATI RRAFSHNALTË E MADHE NË AZI			HUMANISTI BIÇIKEMI LLOJ SHPENDI I EGËR					BASHKËT. THIKË QË MBAHEJ SI ARMË BREZI (sh.shq.)	
	IRNOSET (bised.)				DAFINË PJESE E DITËS			GJITAR I DETEVE POLARE BASHKËT.			NJËSI PESHE (vjet.) PERËNDESHË E DASHURISË (mit. romake)		
	KËPUCËT PËR RRËSHQITJE MBI AKULL						PYLL "RADIO TELEVISIONI ITALIAN"			FEUDAL QË I NËNSHTROHEJ MBRETTIT BASHKËT.			
	OMANI, TANZANIA		MAKINË GËRRYESE RESHAT ARBANA				PREMTIM QË JEPET PËR TË BËRË NJË DIÇKA NË NJË KOHË TË CAKTUAR NAIM OSMANI					BASHKË, TOK "MESINA"	
	NJËSIA MONETARE BAZË E ITALISË					VENDËS BASHKËT.				PJESE E SHTËPISË BASHKËT.			ZANORE
	I PESHOVA					KËNGËTARJA ME FAMË BOTËRORE CELINE ....				KAPELË E RRUMBULL-AKËT PA STREHË DHE PA RRETH ANASH			

ZGJIDHJA E FJALËKRËQIT: ANATOMIZOJ, LAMELA, ETAT, ARRAT, TUTORI, NANOMELI, AV, I TERUR, ANA, SIT, ANIMA, R, M, VU, UJITA, SI, O, UNITETI, KUSAR, RIGA, ERARËT, URAGANI, AN, TAHIRI, LUNAR, SERIK, TAKIM, EG, N, BEL, MISIRI, LO, TUNEI, TERIM, VITI, AAU, AJ, VITET, ETA, ILET, KATËT, KOTEM, I, IMAMATËT, SABATO, RAT, TAROT, MARIN, R, IRET, LAR, FOKA, OKA, PATINAT, MAL, VASAL, OT, BAGER, ZOTIM, ME, LIRETA, ANAS, DHOMA, I MATA, DION, BERETA.



Gjashtë vite pa më të dashurin tonë

## Skender Bytyqi

(08.04.1952 - 09.10.2013)

Mund të shkruaj për orë të tëra, por një gjë është e sigurt, asgjë nga këto që them apo shkruaj, nuk mund të jetë e mjaftueshme për të përshkruar dashurinë që kemi për ty.

Baba ynë i dashur, u bënë gjashtë vite nga mungesa e jote fizike, por ti përherë mbetesh në mesin tonë, në kujtesën dhe zemrat tona. Edhe pse rrugëtimi ynë i përbashkët për ne ishte tepër i shkurtër, ti na edukove dhe na mësove shumë. Tani po vazhdojmë jetën pa ty, por me mësimet tua dhe përvojën tënde që na le trashëgim.

Ne jemi më krenarët që të patëm ty si baba.

**Të kujtojmë me mall të pa shuar: Bashkëshortja Nazmija,  
Vajzat: Ganimetja, Violeta dhe Shkurta  
Djemtë: Gazmendi dhe Armendi dhe e gjithë familja**



Lagja Ulpiana | Rr. Zija Shemsiu | Nr. 34 | Prishtinë | 10000 | Kosovë  
T: 038 700 000 | F: 038 700 001 | E: office@ipko.net | W: www.ipko.com

### FTESË PËR OFERTIM

IPKO Telecommunications LLC njofton të interesuarit se bën shitjen e kabllove koaksiale dhe fibrave të përdorura.

Dokumentacioni me kushtet e pergjithshme per shitjen e veturave mund të tërhiqet prej dates **08 deri me 11 Tetor 2019** në ndërtesën e IPKO-s në Rr. Zija Shemsiu nr.34, Ulpianë – Prishtinë.

Oferta duhet të dorëzohet në: IPKO Telecommunications LLC, Rr. Zija Shemsiu nr. 34, 10000 Prishtinë, Kosovë, jo më vonë se **18 Tetor 2019 në ora 14:00h.**

Nëse keni ndonjë pyetje sa i përket ftesës për ofertim, ju lutem na shkruani ne adresën elektronike [procurement@ipko.com](mailto:procurement@ipko.com)

Me respekt

IPKO Telecommunications  
Rr. Zija Shemsiu nr.34 Ulpiane  
[procurement@ipko.com](mailto:procurement@ipko.com)

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Skender Voca, shpall të pavlefshme Diplomën e SHMT. "Anton Çetta " Skenderaj.

► Viktor Gecaj, shpall të pavlefshme Diplomën e SHM. (drejtimi mat. Inform) "Hamëz Jashari" Skenderaj.

► Vasil Ilaz Avdiu, shpall të pavlefshme Diplomën e SHML (gjimnazi shkencave shoqerore) "Hamëz Jashari" Skenderaj.

► Gentian Karaxha shpall te pa vlefshme diplomën e Sh.M.Teknike "Nexhmedin Nixha " në Gjakovë.

► Burbuqe Tabaku shpall te pa vlefshme diplomën e Sh.M. Ekonomike "Kadri Kusari " në Gjakovë.

► Labinot Shkreta shpall te pavlefshme dëftesën e kl. X / SH.M.L "Dardania" Hani Elezit

► Skender Jonuzi shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

► Vildon Bajra shpall te pavlefshme deftesat e kl I - IX shf "Ekrem Rexha Drini " Lubizhd.

► Veton Krasniqi shpall te pavlefshme diplomën shme "Ymer Prizreni " Prizren.

► Dion Kukaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI -IX shf "Emin Duraku" Prizren.

► Gramoz Rexhaj shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

► Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qera në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Industria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales